

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – Praktikat dhe mjetet më të mira për një rol transformues

Hulumtim Politikash



Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë – Praktikrat dhe Mjetet më të Mira për një Rol Transformues

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillimi i Qëndrueshëm**

Publikimi: **Tetor, 2020**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) mbështetur nga GIZ. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



german
cooperation

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

giz
Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Përmbajtja	2
Lista e tabelave dhe figurave	3
Lista e shkurtesave	4
1. Hyrje	5
2. Metodologjia	6
3. Historia e fondeve për Eficiencë të Energjisë dhe EE	7
4. Korniza institucionale e Sektorit të Eficiencës së Energjisë në Kosovë	11
5. Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë	13
5.1. <i>Korniza ligjore dhe rregullative</i>	13
5.2. <i>Struktura e FKEE</i>	14
6. Shqyrtim i praktikave më të mira lidhur me fondet globale dhe rajonale të EE	16
<i>Fondi Armen i EE dhe energjisë së ripërtëritshme</i>	16
<i>Fondi Bullgar EE</i>	17
<i>Fondi Kroat për Mbrojtjen e Mjedisit dhe EE</i>	19
<i>Fondi Moldav EE</i>	20
<i>Fondi Rumun EE</i>	22
<i>Fondi Tailandez EE</i>	25
7. Mjetet për rol transformues të FKEE	26
7.1. <i>Përvoja e gjertanishme</i>	26
7.2. <i>Barrierat e rëndomta</i>	28
7.3. <i>Mjetet për të filluar dhe efektet në tregun e EE</i>	30
8. Përfundim	36
9. Rekomandime	38
Aneksi I. Skema e organizimit të brendshëm të personelit të FKEE	42

Lista e tabelave dhe figurave

Tabelat

Tabela 1. Parametrat kryesor të FKEE	14
Tabela 2. Dispozitat kryesore të ligjit të EE të Kosovës në lidhje me FKEE.....	15
Tabela 3. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Armen EE	19
Tabela 4. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Bullgar EE.....	20
Tabela 5. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Kroat EE	22
Tabela 6. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Moldav EE	23
Tabela 7. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Rumun EE	24
Tabela 8. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Tajlandez EE	25
Tabela 9. Përmbledhje e parametrave kyç për Fondet e zgjedhura EE.....	26
Tabela 10. Kursimet vjetore të përlllogaritura të energjisë nga FKEE	28
Tabela 11. Përlllogaritja e ndikimeve tjera gjatë periudhës 15-vjeçare	29
Tabela 12. Si FKEE mund t'i adresojë pengesat kyçe për investimet në eficiencën e energjisë	31
Tabela 13. Procesi i Aplikimit për Financim EE dhe Cikli i Projektit	33

Figurat

Figura 1 Pamje skematike e institucioneve të sektorit EE në Kosovë.....	11
Figura 2. Përmbledhje e themelimit të FKEE	13
Figura 3 Organizimi institucional i FKEE	16
Figura 4. Pagesat sipas Marrëveshjes së Shërbimit të Energjisë	32
Figura 5. Tregu i eficiencës së energjisë në Kosovë dhe faktorët ndikues	36

Shenjat dhe njësitë matëse

CO₂	Dioksid karboni
CO₂e	Ekivalent i dioksidit të karbonit
GWh	Gigavat/orë
ktoe	Ekivalent i kiloton të naftës
KWh	Kilovat/orë
GWh	Gigavat/orë
M	Miliona
MtCO₂	Ton metrik i dioksidit të karbonit
MWh	Megavat/orë

Lista e shkurtesave

TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
KE	Komisioni Evropian
EE	Eficienca e energjisë
DEE	Direktiva për Eficiencë të Energjisë
MShE	Marrëveshjet e Shërbimit të Energjisë
OShE	Ofruesit e Shërbimeve të Energjisë
ESCO	Kompania për kursim të energjisë
ESMAP	Programi për asistencë në menaxhim të sektorit të energjisë
BE	Bashkimi Evropian
GEF	Lehtësia globale për mjedisin
GHG	Gazrat serë
IEA	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare
FKEE	Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë
AKEE	Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë
PKEE	Plani Komunal për Eficiencën e Energjisë
MEM	Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit
M&V	Masat dhe Verifikimi
ShA	Shtetet Anëtare
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
NPZE	Ndërtesat Pothuajse Zero-Energji
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
MSA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
AT	Asistenca teknike
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
GBB	Grupi i Bankës Botërore

1. Hyrje

Qytetërimi ynë funksionon me energji dhe burimet tona të paripërtëritshme të energjisë janë të kufizuara. Kërkesa në rritje po zvogëlon furnizimet tona të energjisë së paripërtëritshme me një ritëm shumë më të shpejtë sesa që është parashikuar. Prandaj, zvogëlimi i konsumit të energjisë duke rritur eficiencën e energjisë (EE) si dhe kalimi në burime të ripërtëritshmenovueshme, janë disa nga çështjet kryesore me të cilat përballlet shoqëria sot. Në nivel global eficientia e energjisë kuptohet gjithnjë e më shumë si përbërës kyç i politikës së energjisë me karbon të ulët¹. Energjia është një mundësues i rëndësishëm i zhvillimit dhe është thelbësore për zgjidhjet drejt një planeti të qëndrueshëm, siç njihet në Agjendën 2030 dhe në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) 7 “Energji e përballueshme dhe e pastër”². Caqet e OZHQ 7 përfshijnë dyfishimin e nivelit global të përmirësimit të eficiencës së energjisë. Sipas raportit të IEA³, përmirësimi i eficiencës së energjisë do t’i ulte faturat e energjisë për konsumatorët për më shumë se 500 miliardë dollarë në vit.

Ekonomitë e reja përballen me sfida të panumërta për t’i plotësuar nevojat për energji të popullsisë së tyre në rritje. Pa ndryshime thelbësore teknologjike⁴, konsumi në rritje i energjisë në ekonomitë e reja gjithashtu nënkupton emetimin e më shumë gazrave serë (GHG) në atmosferë. Përkundër disa progreseve në dekadën e fundit në politikat e energjisë, eficientia e energjisë mbetet sfidë e madhe për Kosovën. Sektori i energjisë në Kosovë vazhdon të vuajë nga mungesa e konsiderueshme në prodhimin e energjisë elektrike, në financim, shoqëruar me rritjen e kërkesës për energji dhe përdorim jo-eficient të energjisë. Për shkak të zhvillimeve gjeopolitike, luftës dhe problemeve të shumta ekonomike, pa dyshim se Kosova renditet si një nga shtetet më së paku të zhvilluara në rajon në lidhje me eficientinë e energjisë. Shumica e shtëpive në Kosovë, përfshirë ndërtesat e vjetra dhe të reja, nuk i plotësojnë standardet e EE⁵.

Sidoqoftë, situata me EE të ulët në Kosovë, nga aspekti i konsumit dhe i prodhimit, ofron një potencial të madh për kursimin e energjisë me kosto eficiente. Me kërkesën për energji që pritet të rritet me 4.6% në vit mesatarisht, përmirësimi i EE në ndërtesa është bërë kërkesë urgjente për zhvillimin ekonomik⁶. Qeveria e Kosovës shpenzon mbi 24 milion € në vit për faturat e energjisë për ndërtesat publike dhe mund të kursejë 20-30% në vit përmes masave me kosto efektive të EE.⁷ Ashtu si në pjesën tjetër të Evropës⁸, më shumë për shkak të gjendjes së vjetër dhe ngrohjes së pamjaftueshme efektive, sektori rezidencial konsumon pjesën më të madhe të burimeve të energjisë me 32.8%. Banka Botërore vlerëson se potenciali për përmirësimin e EE në Kosovë aktualisht vlerësohet në 44% me ndërtesat publike që kanë potencialin më të lartë për kursimet e EE⁹. Kjo do të thotë se mund të arrihen kursime të konsiderueshme të konsumit të energjisë dhe këto kursime sigurojnë kursime të konsiderueshme buxhetore për buxhetin e Kosovës si dhe gjithashtu ndikojnë pozitivisht në zvogëlimin e ndotjes dhe GHG.

¹ Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (2016), Raporti i Tregut të Eficiencës së Energjisë 2016. Paris: IEA.

² Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB në dispozicion në: <https://sdgcompass.org/sdgs/sdg-7/>

³ Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (2018), Analiza e Eficiencës së Energjisë dhe Parashikimet deri në vitin 2040; OECD/IEA: Paris, Francë.

⁴ Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (2018), Raporti i Tregut të Eficiencës së Energjisë 2018. Paris: IEA.

⁵ Banka Botërore (2013), Studimi Kombëtar i Eficiencës së Energjisë së Ndërtesave për Kosovën. EPTISA.

⁶ Banka Botërore (2019), në dispozicion online: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/brief/ee-in-kosovo>

⁷ Banka Botërore (2015), Studim i stokut të ndërtesave: Studimi i Fizibilitetit të Eficiencës së Energjisë dhe Masave të Zbatimit në Ndërtesat Publike në Kosovë.

⁸ Banka Botërore (2013), Studimi Kombëtar i Eficiencës së Energjisë së Ndërtesave për Kosovën. EPTISA.

⁹ Banka Botërore (2019), në dispozicion online: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/brief/ee-in-kosovo>

Në përputhje me strategjinë e BE për 2020, Strategjia Shtetërore e Energjisë e Kosovës¹⁰ një nga objektivat kryesore tona në përmbushjen e synimeve dhe detyrimeve në EE, BRE dhe mbrojtjen e mjedisit. Si Palë Kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (IKE) dhe si nënshkruese e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), Kosova është e detyruar ta transpozojë dhe zbatojë *acquis*¹¹ të BE lidhur me Eficiencën e Energjisë. Sidoqoftë, Kosova nuk është në rrugën e duhur për ta arritur objektivin e saj të eficiencës së energjisë.¹²

Për më tepër, siç përcaktohet në Kartën e Qëndrueshmërisë së Ballkanit Perëndimor¹³, deri në qershor 2018 është dashur të krijohen mekanizmat e financimit, shembull një “fond i nivelit shtetëror për bashkëfinancimin e masave të eficiencës së energjisë” që rezulton nga Direktiva e Eficiencës së Energjisë (EED) 2012/27/EU, veçanërisht për sektorin publik.

Presioni i vazhdueshëm pozitiv nga BE dhe hisedarëve vendas e shtyu qeverinë e Kosovës që ta krijojë në vitin 2019 Fondin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) për ta përkrahur ndryshimin transformues drejt zhvillimit rezilient klimatik me karbon të ulët. Fondi do të veprojë si katalizator për zhvillimin e projekteve të eficiencës së energjisë në tregun e Kosovës. Prandaj, ky punim synon të ofrojë një përmbledhje të praktikave më të mira në lidhje me Fondin e sapo-themeluar të Eficiencës së Energjisë, në mënyrë që t’i sigurojë FKEE një sërë mjetesh, konceptesh dhe rekomandimesh përmes së cilave Fondi mund ta organizojë punën e tij dhe t’i hedhë themelet për një ndikim më të madh në sektorin e eficiencës së energjisë gjatë viteve të ardhshme.

Së pari, punimi paraqet një histori të shkurtër të EE, pastaj përcakton më në detaje statusin, strukturën dhe funksionimin e FKEE, karakterizon ofruesit e tij kryesorë dhe diskuton se ku dhe si burimet koncesionare janë më të nevojshme për t’i adresuar boshllëqet e investimeve të EE në sektorët prioritar. Tutje, punimi përqendrohet në rolin transformues të FKEE dhe konsideron rëndësinë e tij në përmbushjen e caceve të EE në Kosovë, kursimet e ardhshme të energjisë, dhe marrëdhëniet e tyre me kompanitë e energjisë.

Gjatë gjithë procesit të këtij hulumtimi, disa kufizime janë hasur në hapa të ndryshëm të shkrimit, nga mbledhja e të dhënave e deri te analizimi i të dhënave. Sidoqoftë, për shkak të pandemisë botërore të sëmundjes koronavirus (COVID-19) kufizimi kryesor ishte mbajtja e intervistave me hisedarët kryesor, veçanërisht nga FKEE dhe AKEE.

Në përfundim janë identifikuar sugjerimet për FKEE, duke i marrë parasysh praktikat e qëndrueshme nga FKEE, e themeluar shumë kohë më parë, me raste studimi nga Armenia, Bullgaria, Kroacia, Moldavia, Tajlanda dhe Rumania. Në fund janë ofruar edhe rekomandimet se si të sigurohet një e ardhme e fortë, efektive dhe e qëndrueshme për FKEE.

2. Metodologjia

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është identifikimi i veglave më të mira për FKEE për t’i shtuar vlerë EE në Kosovë dhe për t’i përmbushur objektivat e EE. Kjo është bërë duke hetuar në mënyrë analitike gjashtë raste studimore nga fondet rajonale dhe globale të EE. Pastaj, karakteristikat e këtyre fondeve të EE krahasohen me karakteristikat e FKEE dhe konkluzionet e nxjerra mbi suksesin e tyre

¹⁰ Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017–2026, në dispozicion online: https://mzhe-ks.net/repository/docs/Energy_Strategy_of_the_Republic_of_Kosovo_2017_-_2026.pdf

¹¹ ‘Acquis’ i BE-së është trupi i të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta që janë të detyrueshme për të gjitha shtetet e BE-së, si Anëtare të BE-së, të disponueshme online: <https://eur-lex.europa.eu/summary/glossary/acquis.html>

¹² Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (2017), Plani i tretë Kombëtar i Veprimit për EE (PKVEE) në Kosovë.

¹³ Karta e Qëndrueshmërisë e Ballkanit Perëndimor, e disponueshme online: https://www.energy-community.org/dam/jcr:3a24e29c-0c32-459c-83b9-7ba99448f2ca/WB6_SUS_Charter.pdf

të mundshëm. Gjetjet nga të dy grupet e analizave janë mbledhur së bashku, bashkë me reflektimin mbi trendet më të përhapura të veglave të suksesshme të fondeve të EE, për ta krijuar një diskutim mbi rolin e ardhshëm të FKEE. Kështu, informatat për fondet e EE të gjashtë shteteve (Armenisë, Bullgarisë, Kroacisë, Moldavisë, Rumanisë dhe Tajlandës) janë shqyrtuar dhe karakteristikat kryesore të fondeve të zgjedhura të EE janë distiluar nga literatura. Për më tepër, analiza në këtë punim përfshin të dhëna dytësore, të marra përmes burimeve në internet, si portale qeveritare, raporte të Bankës Botërore, raporte të hulumtimeve, studime nga organizata lokale dhe ndërkombëtare, etj.

Kriteret e vendosura për t'i zgjedhur rastet studimore kanë qenë ngjashmëritë e të njëjtit rajon me shtetet e Ballkanit që kanë një mekanizëm të ngjashëm qarkullues si dhe kanë relevancë për situatën në Kosovë. Në lidhje me shembullin armen, ekzistojnë disa ngjashmëri interesante në mes të sektorëve të energjisë në Kosovë dhe Armeni, siç është fakti që burimet kryesore të furnizimit me ngrohje për familjet janë energjia elektrike dhe dru zjarri dhe çmimet për të dy këto burime të energjisë janë nën koston e tyre të furnizimit. Në të dyja shtetet, një pjesë e madhe e familjeve jetojnë në nivele me të ardhura të ulëta që i pengojnë ata të marrin pjesë në ndonjë skemë financimi me bazë komerciale. Një ngjashmëri tjetër është se ka skema të shoqatave të banimit në Armeni të cilat veprojnë me sukses të kufizuar, për shkak të pengesave në financimin e projekteve të përbashkëta. Arsyeja për këtë qëndron në ndryshimet e konsiderueshme në kapacitetet financiare të familjeve brenda të njëjtës ndërtesë. Lidhur me fondin EE nga Tajlanda, arsyeja e përzgjedhjes ishte sepse ai është një nga fondet e para të themeluara të EE në botë (1992) dhe ka shumë raporte, informacione, praktika dhe mësim nga ky fond i EE.

Shembujt e përzgjedhur janë motivuar nga fondet e EE kryesisht për t'i analizuar sfidat e tyre me të cilat përballen dhe zgjidhjet e ofruara (pro dhe kundër) dhe për t'i gjetur qasjet, mjetet dhe praktikën më të mira për financim dhe funksionim të qëndrueshëm. Duke thënë këtë, secili shembull u mor për ta prodhuar një mësim, praktikë të mirë ose një mjet për FKEE të qëndrueshëm. Tjetra, ne e shqyrtoam këtu përvojën e hershme dhe mësimet nga Fondet globale të EE në vendet në zhvillim dhe në tranzicion të përkrahur nga Banka Botërore, GEF, etj. Kështu, metodat e përdorura në këtë dokument janë shqyrtim i literaturës akademike dhe zyrtare për gjashtë fondet e zgjedhura të EE si dhe një sintezë e të dhënave të marra. Është eksploruar edhe një analizë e thelluar e Fondit aktual të Kosovës për Eficiencë të Energjisë për ta marrë një pamje më të mirë.

Punimi bazohet kryesisht në shqyrtimin e mbi 50 hulumtimeve në lidhje me fondet EE dhe mekanizmat tjerë financiarë të EE në të gjithë botën. Në fund, punimi jep konkluzione dhe rekomandime që mund ta formojnë bazën e funksionimit të qëndrueshëm të FKEE.

3. Historia e Eficiencës së Energjisë dhe fondeve të EE

Që nga historia e lashtë, njeriu është përpjekur të bëjë më shumë me më pak dhe këtë domosdoshmëri e ruajmë deri sot, kur njerëzimi po ballafaqohet me burime të fundme të energjisë së paqëndrueshme përpiqet ta ruajë stilin e vet të jetës duke shfrytëzuar më pak energji.

Menaxhimi i energjisë dhe përmirësimi i eficiencës së energjisë ka qenë prej kohësh i rëndësishëm për industrinë dhe tregtinë. Duke filluar nga vitet 1790, motorët me avull të Boulton dhe Watt nisën prodhimin e avantazheve konkurruese sepse ishin më eficient me karburant - në të vërtetë, këta motorë ngarkonin një pjesë të kursimeve të karburantit në mënyrë të ngjashme me kontratat e sotme të performancës së energjisë.

- **Kontraktimi i performancës së energjisë:** *Libet një motor me avull tek ju falas. Kompania e instalon dhe e merr përsipër mirëmbajtjen për pesë vjet. Ju garanton se thëngjilli për makinerinë kushton më pak sesa shpenzoni aktualisht për foragjere (energji) për kuajt, të cilët e bëjnë të njëjtën punë. Dhe gjithçka që kërkohet nga ju, është ndarja e kursimeve.* (Xhejms Vat).

Kriza e naftës që shpërtheu në vitin 1973, ndjekur nga rritja e çmimeve të energjisë dhe mungesa e naftës, ka çuar në kuptimin se burimet e energjisë në botë mund të mos jenë të mjaftueshme për ta mbajtur nivelin e konsumit të njerëzimit. Në Luftën e Dytë Botërore, eficientia e karburantit u bë jetike për përpjekjet e luftës dhe Shërbimi Kombëtar i Eficiencës së Karburantit Industrial u krijua për t'i dhënë këshilla industrisë për masat e kursimit të energjisë ndërsa mungesat e karburantit vazhduan në vitet e pasluftës.¹⁴ Për më tepër, koncepti i EE u popullarizua shumë në vitet 1970 kur disa nga shtetet e kuptuan potencialin e kursimit të energjisë. Historikisht, koncepti i eficientisë së energjisë ka histori të gjatë në SHBA, Britani të Madhe, Japoni dhe Gjermani. Pionier në promovimin e eficientisë së energjisë ishte shteti i Kalifornisë në SHBA që filloi zbatimin e masave të EE, të tilla si kodet e ndërtimit dhe standardet e pajisjeve, në mesin e viteve 1970.

Politika e parë e EE në SHBA është Akti i Politikave të Energjisë dhe Konservimit të vitit 1975¹⁵ që iu përgjigj krizës së naftës të vitit 1973 duke krijuar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj politikave federale të energjisë.

Presidenti i SHBA Xhimi Karter lëshoi urdhrin e parë ekzekutiv në lidhje me eficientien e energjisë dhe paraqiti në Kongres një Plan Kombëtar të Energjisë në 1977. Plani Kombëtar i Energjisë i Karterit¹⁶ e ka identifikuar eficientien e energjisë si gur themel për shkak të vërtetimit se “*konzervimi është burimi më i shpejtë, më i lirë, më praktik i energjisë*”. Programi i parë shtetëror i energjisë u krijua në fillim të viteve 1970 dhe alokoi më shumë se 3.1 miliardë dollarë për grante, që aktualisht po përfshihet në programe të ndryshme në të gjithë SHBA¹⁷. Koncepti ESCO, i cili u zhvillua në Amerikën e Veriut në fund të viteve 1970¹⁸, shpesh paraqitet si mekanizëm model i shpërndarjes për retrofitet e eficientisë së energjisë në shtetet në zhvillim dhe ekonomitë e reja të tregut. Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar, Departamenti i Energjisë nisi një program të ri të eficientisë së energjisë më 9 dhjetor 1974¹⁹. Politika e parë e Japonisë për kursimin e energjisë u implementua në 1947; ndërsa, politika e saj energjetike u bë shumë më e sofistikuar pas krizave energjetike të viteve 1970²⁰. Nga ana tjetër, masat e Gjermanisë për izolimin termik të mureve u implementuan më 1978. Bazuar në atë që u tha më lart, krijimi i fondeve të eficientisë së energjisë/konservimi do t'i përshpejtojë dy masa të menjëhershme, një mekanizëm për të ofruar shërbime të EE dhe një mekanizëm për t'i monitoruar dhe vlerësuar kursimet e arritura. Shtetet në të gjithë botën kanë shfrytëzuar lloje të ndryshme të financimit dhe mekanizmave të shpërndarjes për t'i përkrahur investimet në eficientie të energjisë. Kështu, Fondet e Eficientisë së Energjisë u krijuan në të gjithë globin, shpesh me përkrahje

¹⁴ Fawkes, S. (2015), Një histori e shkurtër e Eficientisë së energjisë; Në dispozicion online: <https://www.onlyelevenpercent.com/a-brief-history-of-energy-efficiency/>

¹⁵ Politikat e energjisë dhe akti i konzervimit, në dispozicion online: <https://www.govtrack.us/congress/bills/94/s622/text>

¹⁶ Peters and Woolley, “Jimmy Carter: Fleta e Fakteve të Programit Kombëtar të Energjisë për Programin e Presidentit”, në dispozicion online: <https://www.presidency.ucsb.edu/documents/national-energy-program-fact-sheet-the-presidents-program>

¹⁷ Aleanca për të Kursyer Energji (2013), Historia e Eficientisë së Energjisë, në dispozicion online:

https://www.ase.org/sites/ase.org/files/resources/Media%20browser/ee_commission_history_report_2-1-13.pdf

¹⁸ Taylor, P. R., Govindarajalu, C., Levin, J., Meyer, S. A., dhe Ward, A. W., (2008), *Financimi i eficientisë së energjisë: Mësimet nga Brazili, Kina, India dhe përtej*, Uashington: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/ Banka Botërore.

¹⁹ Peter Mallaburn & Nick Eyre (2012), Mësimet nga politikat dhe programet e EE në MB 1973 deri në 2012.

²⁰ Qendra e Konzervimit të Energjisë, Japoni, “Ne i përkrahim aktivitetet tuaja të konzervimit të energjisë”. Në dispozicion online: <https://eneken.ieej.or.jp/data/4746.pdf>

nga institucionet financiare ndërkombëtare si Banka Botërore ose nga instrumentet e financimit të klimës siç është Lehtësia globale për mjedisin.

Japonia në 1978 e themloi Qendrën e Konservimit të Energjisë të Japonisë²¹. Qeveria e Britanisë krijoi Trustin e Kursimit të Energjisë në 1992. Një nga fondet e para të EE është Fondi i Konservimit të Energjisë²² që u themelua në 1992 në Tajlandë.

Ndërsa në Bashkimin Evropian (BE) dispozitat e Direktivës 2006/32/EC²³ në veçanti neni 11, parashikon që Shtetet Anëtare (ShA) kursejnë çdo vit 1% më shumë energji, kryesisht përmes programeve dhe shërbimeve të efijencës së energjisë. Në mënyrë eksplicite e përmend krijimin e *Fondeve Kombëtare të Efijencës së Energjisë* si një nga mënyrat për ta arritur këtë. Masat e tilla do ta përfshinin promovimin e auditimit të energjisë, instrumentet financiare për kursimin e energjisë, dhe kur është e përshtatshme, edhe njehsimin e përmirësuar dhe faturimin informativ. Më tej, Direktiva 2012/27/EU për Efijencën e Energjisë²⁴, Neni 20 fton Shtetet Anëtare (ShA) që të krijojnë lehtësira të dedikuara financimi - *fonde kombëtare të efijencës së energjisë* për t'i përkrahur investimet në efijencën e energjisë ose për t'i përdorur lehtësirat ekzistuese. Në fund, Direktiva e rindërtuar 2018/844/EU²⁵ për efijencën e energjisë cakton një objektiv të ri, më të lartë, të shfrytëzimit të energjisë për 2030 prej 32.5%. Kjo do të arrihet vetëm nëse Shtetet Anëtare dhe shtetet e TKE i shtojnë përpjekjet e tyre për ta mbajtur nën kontroll konsumin primar të energjisë. Kjo mund të arrihet veçanërisht në shtetet e TKE me normë të rritur, cilësi dhe efektivitet të rinovimit të ndërtesave.

²¹ <https://seforallateccj.org/about-us/#background>

²² Yue et al. (2012), Studimi i Rastit: Fondi i Konservimit të Energjisë në Tajlandë (ENCON).

²³ Direktiva 2006/32/EC për efijencën e përdorimit të energjisë dhe shërbimet e energjisë, në dispozicion online: <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:114:0064:0085:EN:PDF>

²⁴ Direktiva 2012/27/EU për efijencën e energjisë Gazeta zyrtare e Bashkimit Evropian nr.315/1.

²⁵ Direktiva 2018/844/EU, në dispozicion online: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32018L0844&from=EN>

4. Korniza institucionale e Sektorit të Eficiencës së Energjisë në Kosovë

Në lidhje me eficiencën e energjisë, përgjegjësitë kryesore i janë dhënë Ministrisë së Ekonomisë dhe Mjedisit, të tjerat Agjencisë për Eficiencën e Energjisë dhe disa përgjegjësi të vogla Ministrisë së Infrastrukturës dhe Mjedisit. Gjithashtu edhe Fondit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

◇ **Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit**

Kjo Ministri është institucioni kryesor në lidhje me hartimin e politikave për eficiencën e energjisë dhe e mbikëqyr tërë sektorin e energjisë në Kosovë. Ajo u themelua në dhjetor, 2004 me emrin “Ministria e Energjisë dhe Minierave të Kosovës”.

Ekziston një departament dhe disa agjenci përgjegjëse për aktivitetet e eficiencës së energjisë nën Ministri, si në vijim:

- Departamenti i Energjisë është përgjegjës për formulimin e politikave të energjisë, si dhe një politikë strategjike për eficiencën e energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme;
- Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Banimit dhe Ndërtimit është përgjegjës për të propozuar politika; harton dhe zbaton dokumente dhe strategji për fushën e planifikimit hapësinor, ndërtimit, banimit, legalizimit, eficiencës së energjisë në ndërtesa; rregullimin e profesionit të arkitektit dhe inxhinierit në fushën e ndërtimit.
- Agjencia e Eficiencës së Energjisë së Kosovës është agjencia kryesore qeveritare përgjegjëse për implementimin dhe monitorimin e politikave të eficiencës së energjisë sipas Ligjit për eficiencën e energjisë.

◇ **Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë**

Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (në tekstin e mëtejme AKEE) është themeluar në Prill 2012. Gjatë mandatit të saj, Agjencia ka punuar vetëm me tre anëtarë të stafit. Sipas Nenit 6 të Ligjit të vjetër për Eficiencën e Energjisë, detyrat kryesore të AKEE janë si më poshtë:

- Promovimi i eficiencës së energjisë dhe zhvillimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për eficiencën e energjisë;
- Zhvillimi i sistemit të monitorimit të implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe arritjen e caceve indikative për kursimin e energjisë;
- Udhëzon dhe përkrah komunat në përgatitjen e planeve komunale të eficiencës së energjisë dhe raportet e progresit të tyre; dhe
- Promovimi i informimit dhe veprimtarive arsimore në fushën e eficiencës së energjisë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, ndërtimin dhe arsimin.

◇ **Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë**

I themeluar në janar 2019, është subjekti kryesor implementues që menaxhon dhe shpërndan përkrahjen financiare për Programet e Eficiencës së Energjisë në Kosovë. Një përshkrim më i thelluar në lidhje me fondin është dhënë në kapitullin vijues.




Figura 1 Pamje skematike e shkurtër e institucioneve të sektorit të Eficiencës së Energjisë në Kosovë (Burimi: Elaborim i INDEP).

5. Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Kosova ka ndjekur udhëzimet e përgjithshme (Figura 1) nga Traktati i Komunitetit të Energjisë²⁶, direktivat e BE-së, Raporti i Progresit të KE-së²⁷, dokumentet e saj strategjike kombëtare dhe praktikatat më të mira të huaja për ta zhvilluar një mekanizëm financiar gjithëpërfshirës të EE - Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Fondi u adaptua në kontekstin e tij ekonomik dhe shoqëror që do t'i stimulojë qytetarët të investojnë në EE më shumë sesa që normalisht do të investonin. Prandaj, ky fond i dedikuar e ka për mision që të ndërtojë kapacitete të qëndrueshme të bazuara në treg për zhvillimin dhe financimin e projekteve të EE me afate komerciale, të demonstrojë përfitimin financiar të investimeve në sektorin e EE dhe të promovojë zhvillimin e një tregu të EE që funksionon mirë.

Më tej, FKKE shërben si ofrues i pavarur i shërbimit të shtetit për t'i përmbushur objektivat e tij politik në fushën e EE përmes programeve dhe projekteve që janë pjesë integrale e Planeve Kombëtare të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE), Planeve Komunale të Veprimit për Efikasitetin e Energjisë (PKEE), Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (që është duke u draftuar) si dhe dokumentet e tjera strategjike të politikës së energjisë të miratuara nga Qeveria e Kosovës. Prandaj, puna e FKKE do ta ndjekë “qasjen e programit”, me anë të së cilës ai do të jetë një mjet për asistencë financiare për implementimin e projekteve të tilla. Një bord me shtatë anëtarë²⁸ është emëruar për ta mbikëqyrur punën e FKKE, i përbërë nga përfaqësues nga Ministrinë e Financave, Zhvillimit Ekonomik, Administratës Publike, Asociacionit të Komunave të Kosovës,

²⁶ Traktati i Komunitetit të Energjisë, në dispozicion online: <https://energy-community.org/legal/treaty.html>

²⁷ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

²⁸ Rregullorja për Organizimin e Brendshëm, Punësimin dhe Shpërblimin e Personelit të FKKE, e disponueshme në internet: http://fkeekks.net/file/repository/2_IR_int_org_employment_and_remuneration_of_KEEF_ENG_19_2_2019.pdf

Drejtorit Menaxhues të FKEE dhe dy donatorëve të FKEE (pa të drejtë vote) (KE dhe Banka Botërore)

Aktualisht, FKEE i ka shtatë (7) punonjës përveç bordit, ndërsa stafi i ri pritet të punësohet. FKEE siguron sa vijon: bashkëfinancim në nivel kombëtar; para nga donatorët ndërkombëtar; bashkëpunim me bankat e kursimeve (bashkëfinancim i normave të interesit) si dhe siguron fonde për angazhimin e ekspertëve; dhe promovimin e thirrjeve publike.

Udhërrëfyesi i ngjarjes për themelimin e FKEE është dhënë në Figurën 1 më poshtë:




Figura 2. Përmbledhje e themelimit të FKEE (Burimi: Elaborim i INDEP).

Tani e tutje, FKEE është agjencia kryesore implementuese e masave EE në ndërtesat publike. FKEE synon t'i financojë programet dhe masat sipas PKVEE aktuale dhe të ardhshme. FKEE do të hyjë në MShE me përfituesit e duhur për t'i rinovuar ndërtesat e tyre bazuar në sistemin ESCO. Nëse shfrytëzohen MShE-të, lypet që të gjitha investimet komunale të përkrahura nga FKEE të shlyhen nga komunat sipas këtyre marrëveshjeve.

Burimet e financimit të FKEE²⁹ përfshijnë:

- ◇ kapital të qarkulluar të investuar në formën e MShE dhe produktet tjera;
- ◇ të ardhurat nga investimet në formën e tarifave, ngarkesave dhe interesave;
- ◇ të ardhurat nga interesi nga kapitali dhe mjetet e depozituara; dhe
- ◇ kontributet e kapitalit që rrjedhin nga burimet tjera si Skema Obligative të EE, dhe huazimet.

²⁹ http://fkee-rks.net/file/repository/5_IR_on_General_conditions_of_Operations_22_08_2019_ENG.pdf

Tabela 1. Parametrat kryesor të FKKE

Karakteristikat	Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë
Viti i themelimit	2019
Burimi i fondeve	Banka Botërore, BE dhe qeveria e Kosovës
Objektivat e Fondit	Përkrahja e zhvillimit dhe financimi i projekteve të EE në sektorin publik (shkolla, kopshte për fëmijë, spitale dhe ndërtesa tjera të komunave).
Baza ligjore	I themeluar në bazë të Ligjit për Eficiencën e Energjisë Nr. 06/L-079 ³⁰
Organizimi ligjor	Subjekt i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm
Qeverisja	Bordi drejtues me 7 anëtarë (5 qeveri, 2 joqeveritare)
Menaxhimi i fondit	Ekipi i menaxhimit të fondit u zgjodh në mënyrë konkurruese
Komponenti kryesor	Marrëveshjet e Shërbimit të Energjisë (MShE), Fondet e pakthyeshme (grante), instrumentet tjera financiare dhe stimuj që mund të zhvillohen nga FKKE
Projekt tipik	Rehabilitimi i ndërtesave publike (shkolla, kopsht për fëmijë, spitale, ndërtesa komunale) EE në Ndriçimin e Rrugëve Publike, etj.
Numri i projekteve	Nuk dihet
Vëllimi i huave/MShE	17 milion € ³¹ (15 milion nga donatorët, 2 milion nga qeveria)
Kursimi i energjisë gjatë gjithë jetës	Nuk dihet ktoe
Reduktimet e GHG	20000 tCO ₂ e

Burimi: Analiza nga INDEP.

Sic tregohet në Tabelën 1 më lart, është përlogaritur nga modeli posaçërisht i projektuar financiar i funksionimit të fondit, se kontributet e BE-IPA 10 milion € për FKKE do t'i zvogëlojnë emetimet e GHG³² me 20,000 ton/vit.

5.1 Korniza ligjore dhe rregullative e FKKE

Nxitur nga zotimi dhe vizioni i përbashkët i Komunitetit të Energjisë, Kosova e ka zhvilluar kornizën ligjore të sektorit të saj të energjisë dhe EE në mënyrë që ta rregullojë në nivel të brendshëm sektorin e energjisë dhe të sigurojë përmbushjen dhe mirëmbajtjen e detyrimeve të Traktatit. Ligji Nr. 06/L-079 për Eficiencën e Energjisë i miratuar në Nëntor 2018 transponon Direktivën 2012/27/EU për Eficiencën e Energjisë.³³ Ligji për EE i Kosovës krijon bazën ligjore për përmirësimin e EE duke i

³⁰ Ligji i Kosovës për Eficiencën e Energjisë, në dispozicion online: http://mzhe-ks.net/repository/docs/LAW_NO_06_L-079_ON_ENERGY_EFFICIENCY.PDF

³¹ IPA (2017), Përkrahja e BE-së për Fondin e Eficiencës së Energjisë, në dispozicion online: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/ipa_2017_040506.07_ks_eu_support_to_the_energy_efficiency_fund.pdf

³² Po aty, f. 18.

³³ Direktiva 2012/27/EU, në dispozicion online: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32012L0027&from=EN>

përcaktuar synimet kombëtare të efijencës së energjisë dhe duke ofruar rekomandime për implementimin e planeve të veprimit për efijencën e energjisë.

Sipas Neneve 24 dhe 25 të Ligjit Nr. 06/L-079³⁴, FKEE është themeluar si entitet i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm, në përkrahje të objektivave të politikave për EE të Republikës së Kosovës, duke promovuar, përkrahur dhe implementuar masat e EE, si dhe tërheqjen dhe menaxhimin e burimeve financiare në mënyrë që të financojë dhe implementojë projekte investimi në fushën e EE në mënyrë të qëndrueshme. Tabela 2 më poshtë demonstroi më në detaje dispozitat e ligjit për EE në lidhje me Fondin e Kosovës për Efijencë të Energjisë.

Tabela 2. Dispozitat kryesore të ligjit të EE të Kosovës në lidhje me FKEE.

Kërkesa e specifikuar në Ligjin për EE të Kosovës 06/L-079	Seksioni kryesor për FKEE
a) Neni 24	- themelimi i FKEE, nga Republika e Kosovës me këtë ligj.
b) Neni 25	- siguron bazën ligjore për krijimin e FKEE si “entitet juridik i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm jofitimprurës”
c) Neni 27	- “bordi i drejtorëve” - 7 anëtarë (3-qeveritarë, 1-asociacioni i Komunave të Kosovës, 1-drejtor menaxhues i FKEE dhe 2- anëtarë të pavarur - pa të drejtë vote).
d) Neni 33	- “parimet funksionale” - fondi do të funksionojë në bazë programore tre vjeçare dhe vjetore. Aktivitetet do të jenë në përputhje me PKVEE, programet që zbatojnë marrëveshje të qëllimshme dhe veprime tjera të caktuara të FKEE-së sipas parashikimeve të ligjit për EE.
e) Neni 34	- për të siguruar qëndrueshmërinë e tij, FKEE në parim vepron në mekanizëm qarkullues. FKEE mund të mbajë paralelisht një komponent joqarkullues për të ofruar grante, garanci të pjesshme dhe instrumente tjera financiare të jo-qarkullues.
f) Neni 35	-instrumentet financiare-MShE dhe llojet e tjera të marrëveshjeve.
g) Neni 37	- Marrëveshjet e Shërbimit të Energjisë (MShE) do të jenë instrumenti kryesor i FKEE për zbatimin e investimeve të efijencës së energjisë në Subjektet Publike në kuadër të komponentit qarkullues.
h) Neni 5	- përcakton platformën e monitorimit dhe verifikimit (MVP) si platformë për monitorimin e kursimit të energjisë nën PKVEE të Kosovës. Në këtë platformë duhet të raportohen masat e përkrahura nga FKEE.

Burimi: Analiza nga INDEP.

5.2. Struktura e Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë

Megjithëse Fondi nuk shpërndan fitime dhe i duhet miratim nga Qeveria e Kosovës, ai operohet si një strukturë komerciale e financave publike-private dhe shërben për tre role kryesore: është institucion

³⁴Ligji i Kosovës për efijencë të energjisë, në dispozicion online: http://mzhe-ks.net/repository/docs/LAW_NO_06_L-079_ON_ENERGY_EFFICIENCY.PDF

huadhënës, strukturë e garantimit të kredisë dhe në të njëjtën kohë ofrues i asistencës teknike. Ai siguron AT për ndërmarrjet, komunat dhe banorët e Kosovës në zhvillimin e projekteve të EE dhe BRE dhe pastaj siguron financimin ose bashkëfinancimin e tyre ose vepron si garantues ndaj institucioneve tjera të financimit ose huadhënësve komercial. Struktura e brendshme e FKEE, përfshirë skemën e personelit, përshkruhet në detaje në Rregulloren për rregullimin e brendshëm të FKEE³⁵, e cila është paraparë në nenin 42, paragrafi 4.2 i Ligjit për EE. Organet e FKGK janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues. Figura 2 më poshtë e paraqet strukturën institucionale dhe strukturën e organizimit të brendshëm të FKEE që përbëhet nga tre njësi shërbimi (Sekretariati, Zyra Kryesore dhe Shërbimet e Përgjithshme) dhe dy sektorë (Financa dhe Operacionet). Në 3-4 vitet e para të funksionimit të FKEE, numri i parashikuar i stafit të FKEE është dhjetë (10) duke përfshirë Drejtorin Menaxhues me një plan që afërsisht dyfishohet pas kësaj në varësi të fushës dhe kompleksitetit të aktiviteteve të FKEE në të ardhmen.




Figura 3. Organizimi institucional i FKEE³⁶

Në detaje më poshtë nën *Shtojca 1*, paraqiten Njësitë e Brendshme Organizative të FKEE. Bazuar në nenin 39 të Ligjit për Eficiencën e Energjisë³⁷, FKEE do të ketë të drejtë ta ngarkojë marrësin e shërbimeve me tarifë. Për dhënie e përkrahjes financiare në kuptimin e implementimit të aktiviteteve të tij, FKEE³⁸ i përdorë instrumentet e mëposhtme: Marrëveshjet e Shërbimit të Energjisë (MShE), Fondet e pakthyeshme (grante), instrumentet tjera financiare dhe stimuj që mund të zhvillohen nga FKEE

³⁵ Rregullorja për Organizimin e Brendshëm, Punësimin dhe Shpërblimin e Personelit të FKEE, e disponueshme në internet: http://fkee-rks.net/file/repository/2_IR_int_org_employment_and_remuneration_of_KEEF_ENG_19_2_2019.pdf

³⁶ Po aty fq.38

³⁷ Ligji i Kosovës për Eficiencën e Energjisë, në dispozicion: http://mzhe-ks.net/repository/docs/LAW_NO._06_L-079_ON_ENERGY_EFFICIENCY.PDF

³⁸ Neni 4 i Rregullores së Brendshme të FKEE, në dispozicion online: http://fkee-rks.net/file/repository/5_IR_on_General_conditions_of_Operations_22_08_2019_ENG.pdf

6. Shqyrtim i praktikave më të mira lidhur me fondet globale dhe rajonale të eficiencës së energjisë

Seksioni i mëposhtëm jep shembuj të mekanizmave të financimit (fondet e EE) për projektet e EE që vijnë kryesisht nga Evropa Lindore dhe dy nga rajonet tjera të cilat kanë relevancë për situatën në Kosovë. Më tej, për t'i përvetësuar mjetet më të mira për FKKE të qëndrueshëm, i kemi krahasuar gjashtë fonde të EE kryesisht në lidhje me burimet e financimit, mjetet për menaxhimin dhe monitorimin e projekteve të EE si dhe gjetjen e mësimave më të mira nga fondet e zgjedhura. Prandaj, në seksionin më poshtë, i kemi përmbledhur praktikat më të mira të fondeve të zgjedhura të EE (përshkrim i shkurtër i krijimit, objektivave, projekteve të suksesit, nëse fondet ishin të qëndrueshme, etj.). Brenda kësaj analize të gjashtë studimeve të rastit, është paraqitur edhe një analizë e shkurtër (pro dhe kundër) e mësimave të nxjerra nga fondi i zgjedhur i EE (Tabelat 3-8).

Përvoja dhe mësim nga shembujt më të mirë

Ka shembuj të shumtë në tërë botën për përdorimin e Fondeve të Eficiencës së Energjisë për t'i përmbushur sfidat e kursimit të energjisë dhe zvogëlimit të energjisë, si dhe uljen e GHG. Gjashtë shembujt e zgjedhur të fondeve rajonale dhe globale të EE janë paraqitur më poshtë:



Fondi Armen i eficiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme

Në vitin 2006, Fondi i Eficiencës së Energjisë dhe Energjisë së Ripërtëritshme u bë funksional si OJQ e pavarur e bazuar në ligjin për ruajtjen e energjisë dhe për energji të ripërtëritshme.³⁹ Fondi drejtohet nga një bord i besuar i emëruar nga qeveria dhe përfshin përfaqësues nga qeveria, sektori privat, OJQ-të dhe academia.

Fondi në mënyrë efektive vuri në shënjestër objektet publike me potencialin më të lartë për kursimin e energjisë, që në thelb korri suksese të lehta për t'u arritur, por përvoja e gjerë e projektit zbuloi se shumë ndërtesa publike në Armeni nuk ishin në përputhje me kriteret e pranueshmërisë. Fondi Armen investoi përpjekje të konsiderueshme në ndërtimin e kapaciteteve të firmave të ndërtimit, duke i prezantuar ato me kontraktimin e bazuar në performancë, një koncept i ri i prokurimit dhe M&V të kursimeve të energjisë.

Fondi zhvilloi kapacitetin e tij të brendshëm dhe aftësitë teknike për të identifikuar, vlerësuar dhe implementuar projekte të EE⁴⁰. Sipas projektit, Fondi dha shërbime 'deri në çelësat në dorë' (auditim i energjisë, prokurim, dizajn i detajuar, financim, ndërtim dhe monitorim) për gradimet e ndërtesave publike për eficiencë energjisë.

Fondi Armen filloi mekanizmin qarkullues në 2012 për projektet publike të EE duke përdorur MShE. Fondi i ka nënshkruar 73 MShE me vlerë totale prej 12 milionë \$, me madhësi mesatare për projekt rreth \$50,000. Të gjitha MshE-të janë shlyer në kohë dhe të gjitha projektet janë nënkontraktuar për firmat lokale të ndërtimit sipas kontratave të thjeshtëzuara të performancës deri më sot, të gjitha kanë përmbushur ose tejkaluar vlerësimet e kursimeve. Për më tepër, shumë teknologji të reja janë futur, pasi që prokurimi bazohet në vlerën e tanishme neto më të lartë sesa në

³⁹ Limaye, D., Singh, J., dhe Hofer, K., (2014), 'Themelimi dhe Operacionalizimi i Fondit Qarkullues të Eficiencës së Energjisë', *Grupi i Bankës Botërore*, f. 3-36

⁴⁰Banka Botërore. (2016), Raporti i Përfundimit të Implementimit dhe i Rezultateve: Projekt Armen për eficiencë të energjisë. Uashington, DC.

koston më të ulët.⁴¹ Në vend që të zhvillohej si një agjent i pagesave të drejtpërdrejta për t'i financuar retrofitet, Fondi mund të ishte përqendruar në mundësimin e financimit komercial duke vepruar si fond ndërmjetësues i garantimit. Si një fond garancie, ai mund të ketë pagesa plotësisht të de-riskuara për bankat tregtare në bazë rrotulluese, duke tërhequr kështu financime tregtare. Sidoqoftë, për shkak se Fondi Armen bëri pagesa të drejtpërdrejta, ai kryesisht dekapitalizoi veten pa levuar financimin e tij fillestar për të tërhequr financime tregtare.

Projekti ndërtoi një kërkesë për financimin e EE në sektorin publik por modeli nuk është bërë i qëndrueshëm. Përveç nënkontraktimit të firmave private për projektim dhe ndërtim, asnjë entitet tjetër nuk kishte rol në treg, për shembull, identifikimin e projekteve, përgatitjen e vlerësimeve financiare dhe kryerjen e prokurimit. Më e rëndësishmja, Fondi nuk ishte partner me një numër të konsiderueshëm të bankave komerciale në model të bashkëfinancimit. Prandaj, nuk kishte efektin shpërndarës⁴² dhe vazhdimësi, dhe asnjë ndikim në zhvillim përtej ndërhyrjeve të projektit.

Qeveria nuk i dha përkrahje Fondit për ta siguruar përshkallëzimin dhe vazhdimin e modelit të financimit të EE në sektorin publik, i cili është programi i vetëm ekzistues aktualisht në Armeni për këto lloje investimesh. Një mesazh kryesor nga shembulli armen është se fondi në praktikë veproi si një ESCO publike duke qenë shumë tërheqës për entitetet publike. Fushatat e marketingut dhe vetëdijesimit publik ishin kritike në gjenerimin e kërkesës në mes të agjencive publike për shërbimet e energjisë. Fondi ndihmoi në zhvillimin e aftësive të Ofruesve të Shërbimeve të Energjisë (OshE) në Armeni duke përfshirë OShE në sigurimin e disa prej shërbimeve të zbatimit. Niveli i ulët i bashkëpunimit me qeverinë: për më tepër, kishte një përqindje të lartë të refuzimit të kërkesave duke krijuar kosto më të larta administrative sesa pritej. Përdorimi i ESCO mund të përsëritet edhe në rastin e Kosovës. Fondi Armen i Burimeve të Ripërtërishme dhe Eficiencës së Energjisë është një studim i dobishëm i rastit në atë se sektorët e energjisë në Kosovë dhe Armenisë ndajnë disa karakteristika të përbashkëta. Objektivi kryesor i Fondit Armen ishte të siguronte fonde të subvencionuara për një numër të madh të familjeve më pak të pasura, të paafta për të marrë pjesë në lloje të tjera të skemave të financimit.

Tabela 3. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Armen EE.

Anët e forta	Anët e dobëta
Siguron firmat me Kapacitet dhe aktivitetet trajnuese	Nuk ka efekt shpërndarës në zhvillimin e tregut
Ndërtimtaria dhe Industria - që i njeh proceset e Pa bashkëpunim dhe mungesë e përkrahjes saj më mirë sesa qeveria - identifikon masat me kosto efektive	
Fondi ka vepruar si ESCO publike .	Shumë ndërtesa nuk i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë

Burimi: Analiza eksperte nga INDEP.

□ **Fondi Bullgar për Eficiencë të Energjisë**

Fondi Bullgar për Eficiencë të Energjisë u themelua me Aktin e Eficiencës së Energjisë të vitit 2004 dhe është një skemë qarkulluese e huasë, e krijuar për ta lehtësuar financimin e qëndrueshëm tregtar

⁴¹ https://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:GN3s70OnFEWj:https://www.energy-community.org/dam/jcr:83399f2c-c356-4e1a-a596-cafeb20e73dd/EECG_WB_062018.pdf+&cd=3&hl=en&ct=clnk

⁴² Projekti i Eficiencës së Energjisë - Armenia, Raporti i Bankës Botërore (2019), në dispozicion online: http://ieg.worldbank.org/sites/default/files/Data/reports/ppar_armeniaenergy.pdf

për projektet e efijencës së energjisë. Fondi financohet nga tarifat e mbledhura nga taksat mjedisore dhe përdoret për t'i përkrahur klientët që ndjekin iniciativat e EE. Qeveritë bullgare dhe austriake alokuan 1.8 milion \$ dhe 2 milion \$ për ta nisur Fondin. Për ta përmbushur misionin e tij shumëplanësh, fondi shërben si bankë, si strukturë e garantimit të kredisë dhe si kompani këshilluese teknike.

Fondi Bullgar i EE jep hua, garanci të pjesshme të kredisë (80% me bazë *parri passu*⁴³, dhe 50% në bazë të humbjes së parë), si dhe garancitë e portofolit për ESCO-të dhe sektorin e banimit. Garancia e portofolit ESCO mbulon deri në 5% të parazgjedhjeve të pagesave të vonuara të një portofoli ESCO; me këtë garanci, një ESCO mund të merr norma më të mira të interesit për borxhin e saj me bankat tregtare⁴⁴. Meqenëse vonesat në pagesa janë më të mundshme sesa vonesa nga klientët, Fondi vepron si një jastëk financiar ndaj goditjeve. Garancia rezidenciale funksionon si vijon: Fondi ndihmon amvisëritë brenda ndërtesës në zhvillimin e projektit.

Pastaj zgjidhet një kompani për ta implementuar investimin. Banka ia jep fondet zhvilluesit të projektit, por shlyerjet më pas vijnë nga amvisëritë individuale. Secila amvisëri paguan në mënyrë proporcionale me hapësirën e tyre të ndërtuar. Fondi garanton se do ta mbulojë 5% të parë të vonesave brenda këtij blloku (ose portofolin e blloqeve). Statistikisht, normat e vonesës në kreditë e klientëve janë nga më pak se 1% në disa banka, në rreth 2.5-3%, kështu që garancia prej 5% do ta mbulojë plotësisht rrezikun e bankës tregtare⁴⁵. Fondi Bullgar i EE u ka dhënë hua për EE gjithsej 185 projekteve, me investim të përgjithshëm të projektit që ka arritur më shumë se 41.6 milion \$.

Mësim i rëndësishëm i nxjerrë nga rasti i Bullgarisë është nevoja për ta përkrahur qartë fokusin dhe qëllimin e operacioneve që do të trajtohen nga masat financiare të efijencës së energjisë. Dhe, burimi i tij i financimit është i qëndrueshëm sepse financohet nga tarifat e mbledhura nga taksat mjedisore. Prandaj, shembulli i fondit bullgar të EE, i cili ka disa karakteristika të ngjashme me Kosovën, mund të jetë model i dobishëm për burimin e financimit që vjen nga taksat mjedisore. Ndërsa ky program kombëtar është i replikueshëm në shtetet tjera, duhet të theksohet se fushëveprimi dhe aftësia teknike reflektohet nga kushtet e tregut lokal.

Tabela 4. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Bullgar EE.

Anët e forta	Anët e dobëta
I jep firmave fleksibilitet më të madh dhe shumë të lartë të vlerës monetare në përmirësimin e performancës mjedisore	I ngadaltë dhe pa shlyerje
Struktura institucionale është më e thjeshtë dhe më fleksibile	“Kalëruesit falas” □ jo-pjesëmarrës që përfitonin nga veprimet e pjesëmarrësve në marrëveshjet e sektorit të energjisë
Tarifat nga taksat mjedisore dhe administrata më e efektshme	Vështirë për t'i përmbushur investimet për të arritur kursime të larta në energji

Burimi: Analiza eksperte nga INDEP.

⁴³ Pari-passu është një frazë latine që do të thotë “bazë e barabartë” që përshkruan situatat kur dy ose më shumë asete, letra me vlerë, kreditorët ose detyrimet menaxhohen në mënyrë të barabartë pa preferencë.

⁴⁴ Limaye, D., Singh, J., dhe Hofer, K., (2014), ‘Themelimi dhe Operacionalizimi i Fondit Qarkullues të Efijencës së Energjisë’, *Grupi i Bankës Botërore*, f. 3-36.

⁴⁵ Bertoldi, P & Rezessy, S. (2010), *Financimi i Efijencës së Energjisë: Farkëtimi i lidhjes në mes të Financimit dhe Implementimit të Projektit*. Bruksel: Qendra e Bashkuar e Kërkimit e Komisionit Evropian.



Fondi Kroat për Mbrojtjen e Mjedisit dhe EE

Fondi Kroat për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Eficiencën e Energjisë⁴⁶ u krijua në 2004 nga Akti i 2003 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Akti i EE për ta forcuar financimin mjedisor të konservimit, shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe financimit të eficiencës së energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Fondi menaxhon programet në lidhje me pronarët e aseteve private, ndërsa ato që lidhen me sektorin publik janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Agjencisë për Transaksione dhe Ndërmjetësim në Prona të Paluajtshme⁴⁷. Deri në vitin 2014, fondi ka bashkëfinancuar rinovimin e EE të gati 1000 shtëpive dhe implementimin e 3200 sistemeve të burimit të energjisë së ripërtëritshme. Fillimisht, fondi subvencionoi investimet totale në vlerë prej 3,15 milion €. Fondi është themeluar si fond jashtë-buxhetor, që do të thotë se burimet financiare për funksionimin e Fondit nuk janë të siguruara nga buxheti i shtetit. Ato sigurohen nga lloje të ndryshme të tarifave mjedisore⁴⁸, ku të gjitha e ndjekin parimin ‘ndotësi paguan’⁴⁹.

Ekziston një numër i tarifave mjedisore të vendosura nga Kroacia, si tarifatat për emetimet, tarifatat për ngarkimin e mjedisit me mbeturina dhe tarifatat speciale për automjetet motorike.

Stimujt financiar të siguar nga Fondi janë në formën e grantit ose kredisë pa interes⁵⁰. Sidoqoftë, megjithëse EE po merrte vrull në vitet e fundit në Kroaci, ajo ende po përballet me pengesat e zakonshme për një zbatim më të gjerë duke mos i njohur plotësisht të gjitha përfitimet që rezultojnë nga përmirësimi i EE dhe kapacitetet e dobëta financiare të qytetarëve dhe sipërmarrësve.

Prandaj, grantet mbeten forma kryesore e stimujve të siguar në Kroaci për eficiencën e energjisë. Duke pasur parasysh llojet e këtyre pengesave (disponueshmëria e informacionit, barra administrative dhe kapacitetet teknike për zhvillimin dhe përgatitjen e projektit), Fondi, si zbatues i politikave, e realizoi qasjen vijuese: (Dukshmëria dhe komunikimi, procedura të thjeshta dhe të qarta të aplikimit, dhe përkrahja për monitorimin e zbatimit të projektit. Lidhja e aktiviteteve të forta promovuese me procedurat e thjeshta të aplikimit dhe përkrahja e vazhdueshme e ofruar për zhvilluesit e projekteve provuan të jenë rruga përpara.

Programi EE rezidencial është programi më i suksesshëm nga fondi kroat. Filloi me një video promovuese që ishte përgatitur për ta treguar një histori motivuese të familjes - një shembull i rinovimit të suksesshëm që u transmetua në televizionin kombëtar dhe përmes mediave sociale. Më shumë se 30 ngjarje publike u organizuan në të gjithë Kroacinë dhe në fund, zyra e informacionit në mjediset e Fondit dhe linja falas për qytetarët u krijua si një formë e përkrahjes së vazhdueshme për këdo që dëshiron të aplikojë për subvencione ose thjesht që dëshiron më shumë informata për mundësitë për përmirësime të EE në shtëpitë e tyre.⁵¹

Për më tepër, dizajni i skemës së subvencionit u ndryshua ndjeshëm në 2015. Gjegjësisht, para vitit 2015 subvencionet ishin në dispozicion për pronarët e shtëpive vetëm përmes autoriteteve lokale

⁴⁶ Aktet e përgjithshme të Fondit Kroat për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Eficiencën e Energjisë, në dispozicion në: http://www.fzoeu.hr/en/regulations/general_acts_of_the_fund/

⁴⁷ Vlerësimi i shfrytëzimit të mundshëm të ardhshëm të instrumenteve financiare në Kroaci - Raporti i Përkohshëm që fokusohet në sektorin EE/BR, në dispozicion online: https://www.fi-compass.eu/sites/default/files/publications/4-Assessing-the-potential-ututure-use-use-of-FI-in-Croatia_TO1_TO4_TO7.pdf

⁴⁸ http://www.fzoeu.hr/en/environmental_fees/fees_pursuant_to_the_act_on_the_environmental_protection_and_energy_efficiency_fund/

⁴⁹ Parimi ‘ndotësi paguan’ parashikon që ata që prodhojnë ndotje duhet t’i mbulojnë shpenzimet e menaxhimit për ta parandaluar dëmtimin e shëndetit të njeriut ose mjedisit.

⁵⁰ Llojet e Granteve për Fondin e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Eficiencës së Energjisë, në dispozicion online: http://www.fzoeu.hr/en/use_of_funds/types_of_granting_fund_appropriations/

⁵¹ Aktivitetet e Fondit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Eficiencës së Energjisë, në dispozicion online: http://www.fzoeu.hr/en/about_us/activities_of_the_fund/

(autoriteti lokal aplikonte për subvencion në Fond dhe, pas miratimit, shpallte thirrjen për qytetarët dhe e kryente procesin e përzgjedhjes). Kjo qasje ka çuar në situatën që jo të gjithë qytetarët e Kroacisë kishin qasje në subvencione, por vareshin nga gatishmëria e autoritetit të tyre lokal për të marrë pjesë në program. Prandaj, në vitin 2015 u vendos që Fondi të bëhet ‘ofrues i të gjitha shërbimeve’ për të gjithë qytetarët që dëshirojnë të rinovojnë shtëpitë e tyre dhe të përfitojnë nga subvencionet shtetërore për atë qëllim.

Rezultatet ishin të jashtëzakonshme - më shumë se 9.300 qytetarëve u dhanë subvencione për meremetimin energjetik në shtëpitë e tyre familjare. Përafërsisht 13.000 masa EE dhe BRE u aplikuan në ato shtëpi⁵². Ky është një mësim i rëndësishëm për fondet tjera. Përfitimet në drejtim të kursimit të energjisë janë të shënuara qartë nga klasa e energjisë e shtëpisë, ndërsa përfitimet ekonomike janë në më shumë se 700 € fatura më të ulëta të ngrohjes në vit. Modeli kroat i integritimit të sektorit mjedisor si dhe shfrytëzimi i tarifave mjedisore është i aplikueshëm në Kosovë.

Tabela 5. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Kroat EE.

Anët e forta	Anët e dobëta
Auditim falas i energjisë ‘ofrues i të gjitha shërbimeve’ për të gjithë qytetarët.	Sezonaliteti i programit , është i mundur të aplikohet vetëm në kohën e thirrjeve publike
Dukshmëria e lartë dhe komunikimi me zyrën e informimit në ambientet e Fondit dhe linjë falas për qytetarët	Mospërputhja e programeve , në lidhje me nivelin e përllogaritur të parashikuar të financimit
Procedurat e thjeshta të aplikimit dhe databaza e projekteve të implementuara që i tregojnë rezultatet	Vetëm autoritetet lokale mund të lejojnë pjesëmarrjen në projekt

Burimi: Analiza eksperte nga INDEP.

Përvoja kroate tregon se rruga e duhur përpara është në qasje gjithëpërfshirëse që do t’i trajtojë njëkohësisht të gjitha pengesat e perceptuara - informimin, kapacitetet dhe financimin. Një mësim i rëndësishëm nga shembulli kroat është se përpjekjet duhet të bëhen posaçërisht në sigurimin e informimit të mjaftueshëm dhe të dobishëm, i cili do të shërbejë si bazë për vendimmarrje. Informacioni duhet të përmbajë informatat nga projektet e implementuara tashmë në mënyrë që të provojë se eficientia e energjisë funksionon vërtetë në praktikë dhe ka shumë “fitore”, si për individët ashtu edhe për shoqërinë në tërësi, si dhe shfrytëzimi i fondeve si ‘ofrues i të gjitha shërbimeve’ për të gjithë qytetarët.



Fondi i Eficiencës së Energjisë në Moldavi

Fondi Moldav i Eficiencës së Energjisë u krijua në 2012 me dispozitat e Ligjit për Eficiencën e Energjisë dhe Ligjin e Energjisë së Ripërtëritshme.⁵³ Administratori i Fondit është person fizik ose juridik nga Republika e Moldavisë ose nga jashtë, i zgjedhur në përputhje me procedurat e Bankës

⁵² <https://balkangreenenergynews.com/supporting-energy-efficiency-and-renewables-in-croatia-the-role-of-environmental-protection-and-energy-efficiency-fund/>

⁵³ Fondi i Eficiencës së Energjisë i Moldavisë, në dispozicion online: <http://www.fee.md/index.php?page=page&id=366&l=ee>

Botërore. Objektivi kryesor i Fondit është tërheqja dhe administrimi i burimeve financiare për implementimin e projekteve të EE dhe BRE. Është entitet i pavarur juridik, që qeveriset nga një Bord me nëntë anëtarë. Bordi përkrahet nga një Komitet i Investimeve, i përbërë nga tre anëtarë të Bordit. Operacionet e Fondit menaxhohen nga një Drejtor Ekzekutiv dhe një staf prej 16 personave. Fondi përkrahet nga një Administrator Fondi, i kontraktuar veçmas nga Ministria e Ekonomisë. Burimet financiare të Fondit përfshijnë alokimet e buxhetit të shtetit, të paktën 10% nga vëllimi i përgjithshëm i burimeve të disponueshme, të nevojshme për t'i arritur objektivat në sektorët e EE dhe BRE. Burimet tjera financiare: donacione nga persona fizikë dhe juridikë nga Moldavia dhe jashtë saj, IFN dhe partnerë strategjikë, të ardhura financiare nga interesa dhe komisione; hua, dhe instrumente tjera financiarë.

Fondi është një “fond qarkullues” i furnizuar nga rimbursimi i fondeve dhe pagesat e interesit dhe komisioneve. Fondi ofron instrumentet financiare të mëposhtme: grante, garanci, hua dhe qira. Fondi ka organizuar disa raunde të Thirrjeve për Propozime, për investime në EE dhe energji të ripërtëritshme. Fondi gjithashtu ndihmon përfituesit me AT gjatë implementimit të projektit dhe monitoron rezultatet.

Ekipi i Fondeve ka prezantuar informata të detajuara mbi objektet ekzistuese dhe zhvillimin e regjistruar duke vendosur një mekanizëm më të lehtë për përpunimin e dosjeve në lidhje me projektet e implementuara nga sipërmarrësit, si dhe statusin e përditësuar të monitorimit të projektit pas implementimit. Janë bërë disa modifikime të Marrëveshjeve të Grantit për masat e EE dhe vleftësimin e BRE në ndërtesa dhe eficientësinë e sistemeve të ndriçimit publik në procedurat e prokurimit publik dhe aplikimin e ndëshkimeve më drastike nëse identifikohen devijime thelbësore nga detyrimet e Marrëveshjes së Grantit. Sidoqoftë, për shkak të vizitave në terren, u identifikuan devijime nga implementimi cilësor i masave të EE për shumicën e projekteve, për ta korrigjuar atë që fondi i sheh si masa të domosdoshme në bashkëpunim me Përfituesit. Në rast se do të jetë e pamundur që të korrigjohen mospajtueshmëritë, Fondi vendosë për shkëputjen e Marrëveshjeve të Grantit, me detyrimin e përfituesve të projektit që t'i kthejnë të gjitha kontributet e grantit nga Fondi, të paguara deri në përfundimin e Kontratës së Grantit.⁵⁴ Rrjedhimisht, vjen vendimi për krijimin e “listave të zeza” të auditorëve të energjisë, vleftësuesve të ndërtimit, verifikuesve të projekteve (dizajnit teknik) dhe gjeodetëve të sasisë si rezultat i analizës së pengesave të identifikuara në procesin e vleftësimit të shërbimeve të ofruara nga specialistët përkatës, brenda procesit të vlerësimit dhe implementimit të projekteve të Fondit.

Në këtë kontekst, FEE do t'i njoftojë njësitë kombëtare, përgjegjëse për certifikimin e specialistëve të kategorive përkatëse dhe autoritetet kompetente në mënyrë që t'i sanksionojë ata për dhënien e AT jo-cilësore përfituesve të projektit.⁵⁵ Një mësim i rëndësishëm nga Moldavia është se ata e vendosin “listën e zezë të shërbimeve të energjisë” dhe ndëshkimet e projektit apo edhe shkëputjen e kontratës. Kjo do të thotë që FKEE duhet të jenë shumë të kujdesshëm në lidhje me ekspertët e auditimit të energjisë dhe analizat e tyre.

⁵⁴ Fondi i Eficientësisë së Energjisë i Moldavisë, në dispozicion online: <http://www.fec.md/index.php?pag=news&id=390&rid=433&l=en>

⁵⁵ Po aty.

Tabela 6 Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Moldavian EE.

Anët e forta	Anët e dobëta
T&A dhe M&V	Cilësia e implementimit të ulët e masave të EE
Krijimi i “listave të zeza” të auditorëve të energjisë, firmave të ndërtimit etj.	Problemi i “kalërimit falas” - Grantet nuk janë të lidhura me statusin social dhe financiar
Ndëshkimet e mundshme dhe administrimi më i harmonizuar	Vështirë për t’i përmbushur investimet për të arritur kursime të larta në energji

Burimi: Analiza eksperte nga INDEP.



Fondi i Eficiencës së Energjisë në Rumani

Fondi Rumun i Eficiencës së Energjisë u krijua në 2003 përmes një Urdhërese Emergjente nga Qeveria e Rumanisë si një entitet juridik i pavarur dhe autonom. Fondi është i pavarur dhe i veçantë nga çdo agjenci qeveritare, edhe pse financimi fillimisht vjen kryesisht nga GEF dhe konsiderohet financim publik. Fondi mbikëqyret nga një Bord i Administrimit i përbërë nga shtatë përfaqësues nga sektori privat dhe publik rumun, me shumicë të sektorit privat dhe kryesim vjetor të radhës⁵⁶. Fondi synon organet publike dhe kompanitë industriale. Fondi administrohet nga një ekip i vogël menaxherial profesional i kryesuar nga një drejtor ekzekutiv, përgjegjësia kryesore e së cilit është që të sigurojë menaxhimin e përgjithshëm të projektit dhe të shërbejë si ndërlidhësi kryesor me Bankën Botërore dhe qeverinë Rumune gjatë zbatimit të projektit.

Fillimisht, ai u krijua si një fond borxhi qarkullues për të financuar një kombinim të klientëve privatë dhe të sektorit publik me kredi në spektrin prej 100,000 dollarë amerikanë deri në 1 milion dollarë amerikanë⁵⁷. Të qenit ‘ofruer i të gjitha shërbimeve’ përfshin me sa vijon: identifikimin e mundësive të investimit, përcaktimin e strukturës së investimeve specifike, kryerjen e analizës së vlerave të kredisë së klientëve të mundshëm dhe kryerjen e rishikimit teknik/mjedisor dhe analiza financiare e projekteve të investimeve.

Pagesa e projekteve u synua nga tre deri në katër vjet. Të paktën 50 për qind e përfitimeve të projektit kërkohet që të vijnë nga kursimet e energjisë. Meqenëse Fondi është një institucion financiar jo bankar, ai nuk obligohet nga kërkesat e rrepta të administrimit të riskut të Bankës Kombëtare të Rumanisë dhe mund ta strukturojë kolateralin më lirshëm sesa bankat. Nga Fondi Rumun i EE, mësimi kryesor është rëndësia e asistencës teknike (AT). AT, përfshirë iniciativat e financuara dhe kontaktet më informale midis stafit të fondeve dhe aktorëve të tregut, ishte thelbësore për suksesin final të Fondit. AT iu dha bankave, zhvilluesve të projekteve dhe tregut tjetër të eficiencës së energjisë. Prandaj, AT si mjet rekomandohet dhe mund të implementohet lehtësisht nga FKEE.

⁵⁶ Taylor, P. R., Govindarajulu, C., Levin, J., Meyer, S. A., dhe Ward, A. W., (2008), *Financimi i eficiencës së energjisë: Mësimet nga Brazili, Kina, India dhe përtej*, Uashington: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/ Banka Botërore.

⁵⁷ Po aty, f. 185.

Tabela 7. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Rumun EE.

Anët e forta	Anët e dobëta
Aftësia për të vepruar pa mbështetje nga një sistem bankar që ishte jofunksional në vlerësimin e projektit	Mbështetja në kontratë të performancës së prokuruar në mënyrë konkurruese me një Menaxher të Fondit për ta ofruar thelbin e programit në kapacitetin institucional për ‘ofruesi të gjitha shërbimeve’ u provua të ishte qasje e rrezikshme
‘Ofruesi i të gjitha shërbimeve’ për zhvillimin dhe financimin e projektit me kompetenca në eficiencën e energjisë dhe financa	Skema institucionale shumë e ndërlikuar me shumë vendimmarrës me interesa të ndryshme
Financimi për asistencë teknike i dhënë për zhvillimin e projektit dhe ndërtimin e kapaciteteve	Stimuj të pamjaftueshëm për ta shfrytëzuar asistencën teknike për rezultate maksimale të investimeve

Burimi: Analiza eksperte nga INDEP.

EERF Fondi Qarkullues i Eficiencës së Energjisë në Tajlandë

Në vitin 2003, si pjesë e Planit të saj më të gjerë për Konservimin e Energjisë, Qeveria krijoi Fondin Qarkullues të Eficiencës së Energjisë⁵⁸ për t’i inkurajuar investimet nga bankat e Tajlandës për huazim për projektet e eficiencës së energjisë. Trembëdhjetë banka publike dhe komerciale morën pjesë në Fond, që rezultoi në 294 projekte, me investim total prej afro \$ 519 milion (\$ 235 milion nga fondi dhe \$ 284 milion nga bankat tregtare) me 40% në energjinë e ripërtëritshme dhe 60% në EE.⁵⁹ Kursimet totale financiare për shkak të projekteve përllogariten të jenë rreth \$ 177 milion në vit. Kursimet e pritshme të energjisë kanë qenë rreth 320 mijë tonë ekuivalent të naftës (ktoe) në vit, duke çuar në ulje të emetimeve të GHG me rreth 1 milion tonë CO₂-ekuivalent në vit⁶⁰. Ky program ra nën shënjestrën e politikave të Qeverisë së Tajlandës për ta zvogëluar intensitetin e energjisë të Tajlandës me 25% midis 2005 dhe 2025. Ai gjithashtu synon ta promovojë konkurrencën e bizneseve tajlandeze, duke ulur kostot e tyre të energjisë dhe varësinë nga importet e naftës nga jashtë. Sidoqoftë, ka pyetje nëse programi ka qenë efektiv në stimulimin e një tregu të vetë-mjaftueshëm që mund të funksionojë pa stimujt e financave koncesionare dhe asistencës teknike.

Fillimisht ishte efektive në joshjen e interesimit nga bankat tregtare, me numrin e pjesëmarrësve që u rritën nga gjashtë në njëmbëdhjetë gjatë programit. Sidoqoftë, interesimi i tyre nuk u mbështet; siç u tha më parë, vetëm një bankë vazhdon në mënyrë aktive të financojë projekte të EE. Shtrembërimet e tregut të kredisë koncesionare dhe asistencës teknike nxitën interesin fillestar të bankave. Linja e kredisë koncesionare do të thotë që fitimet nga investimet e tyre në EE janë më joshëse, ndërsa asistencë teknike për vlerësimin e projekteve mund të ndihmojë në ndërtimin e kapaciteteve dhe zbutjen e riskut të lartë të perceptuar.

⁵⁸ Grüning, C., Menzel, C., Panofen, T., Shuford, L., (2012), Rast studimi: Fondi Qarkullues Tajlandez i Eficiencës të Energjisë, UNEP/Shkolla e Frankfurtit, në dispozicion online: https://unfccc.int/sites/default/files/fs-unep_thai_eerf_final_2012.pdf

⁵⁹ Streitferdt & Chirarattananon (2015), Përkraja për Financimin e Eficiencës së Energjisë në Tajlandë: Mësimet e nxjerra nga Fondi Qarkullues i Eficiencës së Energjisë. Gazeta e Energjisë dhe Mjedisit të Qëndrueshëm 6 (2015) 13-16

⁶⁰ Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Shkolla e Frankfurtit për Financa dhe Menaxhim, 2012.

Krijimi i Fondit trajtoi disa nga pengesat e investimeve të EE në Tajlandë duke plotësuar obligimet e detyrueshme me programe vullnetare; zhvendosja e përgjegjësisë kryesore për implementim larg Ministrisë, si dhe alokimin e riskut larg Qeverisë; dhe, thjeshtëzimin e procedurave dhe përsheptimin e implementimit të programit. Një mesazh kyç nga Fondi Tailandez EE është krijimi i rrjeteve të financuesve privatë dhe ESCO. Duke mbajtur takime dhe ngjarje, fondi bashkon në mënyrë proaktive bankat dhe ESCO-të. ESCO-të kanë zhvilluar një vitrinë prej rreth 40 projekteve në mënyrë që t'u mësojnë bankave vlerësimin dhe periudhën e kthimit për projektet e EE⁶¹. Për shkak të shtrembërimit të tregut dhe mungesës së përvojës nga reklama e bankës lokale që nuk është e qëndrueshme, me këtë kombinimi, ky lloj fondi i EE mund të mos jetë i arritshëm në Kosovë.

Tabela 8. Përmbledhje e anëve të forta dhe të dobëta të Fondit Tailandez EE.

Anët e forta	Anët e dobëta
Krijimi i rrjeteve dhe ESCO	Nuk u fitua përvoja në projektet e EE nga bankat lokale
Alokimi i rrezikut larg nga Qeveria	Shtrembërimi i tregut
Thjeshtëzimi i procedurave dhe përsheptimi i I paqëndrueshëm , linjë krediti për bankat implementimit të programit	

Burimi: Analiza eksperte nga INDEP

Tabela 9 më poshtë përshkruan disa nga karakteristikat kryesore (Baza ligjore, burimi i fondeve, objektivat, menaxhimi, projektet tipike, kursimet e energjisë dhe zvogëlimi i GHG) i gjashtë fondeve të analizuar EE.

Tabela 9. Përmbledhje e parametrave kyç për Fondet e zgjedhura EE.

Karakteristika	Fondi Bullgar	Kroat	Armen	Moldav	Tailandez	Rumun
Viti themelimit	2005	2004	2005	2012	2003	2003
Burimi i fondeve	Banka Botërore, GEF dhe qeveritë e Austrisë dhe Bullgarisë	Ngarkesat për ndotësit e mjedisit	Banka Botërore, GEF	Qeveria e Moldavisë dhe Banka Botërore	Qeveria Tailandeze	GEF
Objektivat e Fondit	Përkrahja e zhvillimit dhe financimit të projekteve EE	Përkrahja e zhvillimit të projekteve mjedisit dhe financimit të EE	Ulja e GHG duke i hequr pengesat për implementim e investimeve të EE dhe BRE në sektorin publik	Përkrahja e zhvillimit dhe financimit të projekteve EE dhe BRE në Moldavi	Mobilizimi i investimeve tregtare për t'i përmirësuar mundësitë e tregut të huadhënies në EE	Të ndihmohen përdoruesit e energjisë që të përvetësojnë teknologji moderne për shfrytëzimin efikas të energjisë

⁶¹ https://unfccc.int/sites/default/files/fs-unep_thai_cerf_final_2012.pdf

Baza ligjore	I themeluar në bazë të Aktit për Eficiencën e Energjisë të vitit 2004	Themeluar në bazë të Aktit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Eficiencën e Energjisë (Nr. 01-081-03-2395/2)	Ligji për eficiencën e energjisë dhe energji të ripërtëritshme	I themeluar në bazë të Ligjit për Eficiencën e Energjisë dt. 2010, neni 20 (1)	Akti i Programit të Konservimit të Energjisë. B.E. 2535	Urdhëresa Emergjente e Qeverisë
Organizimi ligjor	Organizatë e pavarur	Subjekt gjyqësor	OJQ e pavarur	I pavarur	Qeveritar	Organizatë e pavarur
Qeverisja	Bordi drejtues me 9 anëtarë (4 qeveri, 5 joqeveritar)	Bordi drejtues me një kryesues dhe gjashtë anëtarë	Bordi i Administratoresve - anëtarët përfshijnë qeverinë, sektorin privat, OJQ-të dhe akademinë	Nuk dihet	Departamenti i Zhvillimit të Energjisë Alternative dhe Eficiencës	Bordi i administrimit me 7 anëtarë (2 qeveri, 5 joqeveritar)
Menaxhimi i fondit	Ekipi i menaxhimit të fondit nga sektori privat u zgjodh në mënyrë konkurruese	Bordi Menaxhues	Drejtori i Fondit, Menaxheri Financiar, Koordinatori i Investimeve dhe Koordinatori i AT-së	Kapitali i Zhvillimit të Qëndrueshëm - SDC	Departamenti i Zhvillimit të Energjisë Alternative dhe Eficiencës	Drejtori Ekzekutiv i emëruar nga Bordi; Menaxheri i Fondit menaxhon portofolin e investimeve
Komponenti kryesor	Borxhi, Lehtësia e Financimit; Garancitë e pjeshme të kredisë; dhe AT	Huatë, subvencionet asistencë financiare dhe donacionet	Huatë, MShE dhe AT	MShE, AT, EPC	Huatë me kamatë të ulët për bankat	Financimi i borxhit dhe AT
Projekt tipik	Rehabilitimi i ndërtesave Ndriçimi rrugor EE Përmirësimet në sistemet e shpërndarjes së nxehtësisë	EE e ndërtesave në lidhje me sistemet e ndriçimit dhe ngrohjes, zarfat e ndërtesave.	Përmirësimet në sistemet individuale të ngrohjes Rehabilitimi i ndërtesave publike Përmirësimi i EE nëpër shtëpia dhe	Rindërtimi i ndërtesave (ndriçimi, HVAC, rikuperimi i nxehtësisë dalëse, optimizimi i procesit); Gjenerimi:	Ndërtesat, fabrikat, kompanitë e shërbimeve të energjisë (ESCO) dhe zhvilluesit e projekteve	Zëvendësimi i pajisjeve të vjetra të gjenerimit të energjisë (kaldaja, CHP, hidro, gjeotermale) Modernizimi i pajisjeve të

			ndërtesa.	(CHP, kaldaja, pompa nxehtësie).		industrisë së procesit dhe ndriçimit publik.
Numri i projekteve	185 hua/garanci	78	73 MShE	Nuk dihet	294	20 hua
Vëllimi i huave/MShE	\$41.6 miliona	3.2€ miliona	12\$ miliona	75€ miliona	519\$ miliona	11.4\$ miliona
Kursimi i energjisë gjatë gjithë jetës	130.000 toe	Nuk dihet	8.1 miliona MWh	Nuk dihet	Nuk dihet	36,533 toe
Reduktimet tërjetësore të GHG	1.1 MtCo2e	Nuk dihet	2.2 M tCO2e	Nuk dihet	320 mijë tCO2/vit	183,237 tCO2e

Burimi: Elaborim i INDEP dhe i përshtatur nga Limaye, D., Singh, J., dhe Hofer, K., (2014).

7. Mjetet për rol transformues të FKEE

7.1 Përvoja e gjertanishme

FKEE është një institucion i ri i financimit të EE në vend dhe partneri kryesor zbatues për PKEE, qëllimi i të cilit është zbatimi i nënprojekteve të kursimit të energjisë në objektet komunale. FKEE merr përgjegjësinë e agjencisë zbatuese për projektet e EE nga ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, tani Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit. FKEE përgjegjës për monitorimin e implementimit të disbursimeve. Fondet e donatorëve përdoren për ta siguruar kapitalin e parë të investimeve për FKEE për t'i mbuluar kostot fillestare dhe operative dhe ndërtimin e kapaciteteve EE derisa Fondi të arrijë vetë-mjaftueshmërinë financiare. Gjashtë shembujt e rasteve të fondeve të EE gjithashtu kanë nxjerrë në pah IFN si burim të kapitalit, si qendër informacioni dhe ekspertize për implementimin e efijencës dhe kursimeve të energjisë dhe si lehtësues i partneritetit publik-privat.

Deri më sot, stafi esencial i FKEE është punësuar dhe zyra e përhershme e FKEE është e gatshme. Manuali i operacioneve është hartuar dhe miratuar nga Bordi i Drejtorëve. Manuali jep udhëzime për të gjithë pjesëmarrësit kryesorë të përfshirë në menaxhimin e fondeve, implementimin e projektit dhe rezultatet në monitorim, duke siguruar kështu një kuptim të përbashkët të të gjitha parimeve dhe praktikave operacionale për të gjithë hisedarëve.

Është lansuar thirrja e parë publike për propozime⁶² për projekte EE dhe FKEE ka ftuar të gjitha komunat e interesuara në përmirësimin e EE në ndërtesat e tyre publike dhe sistemet e ndriçimit rrugor. Vëllimi minimal i përlogaritur i investimit për projekt është 20,000 € dhe maksimumi është 500,000 €. Përgjegjësia për monitorimin e implementimit të marrëveshjeve mbahet direkt nga FKEE. Në përgjithësi, FKEE në tre vjet do ta alokojë afërsisht financimin e tij (15-17 milion €) për investimet e sektorit publik për të ndihmuar në mbulimin e qëndrueshmërisë, njohurive dhe boshllëqeve të riskut që mund të ndikojnë në aftësinë e aktorëve privatë dhe stimulimin për të investuar, si dhe investime në objektet e nivelit komunal në ndërtesat publike dhe në ndriçimin publik me qëllim të kursimit të energjisë elektrike.

⁶² http://fkee-rks.net/file/repository/Public_Call_ENG.pdf

Disa nga masat e pranueshme⁶³ duhet të përfshijnë: Përmbushjen e Kërkesave Teknike të Performancës Minimale të Energjisë; Periudhën maksimale e shlyerjes së thjeshtë deri në 15 vjet për të gjithë projektin në një objekt ndërtimor ose në sistemin e infrastrukturës; Maksimum 10% të vëllimit të përgjithshëm të investimeve të projektit mund të përfaqësojë masa jo-EE si reinstalimi i telave, riparimet e vogla strukturore, lyerja, siguria sizmike etj.

Lidhur me potencialin e kursimit të EE përlogaritja e mëposhtme nga një Raport i Bankës Botërore⁶⁴ tregon se qeveria qendrore e Kosovës dhe koha e shlyerjes nga komuna është 5 vjet dhe kursimi i energjisë në total është 152 kWh/m². Sa i përket potencialit të kursimit të EE dhe sipas Programit të Bankës Botërore për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme⁶⁵ me shpërndarjen e investimeve gjatë periudhës 2016-2020 prej 14 milion € nxori kursime totale të energjisë pas të gjitha ndërhyrjeve prej 32.4 GWh/vit (2.79 ktoe/vit). Kjo barazohet me kosto totale prej 0,44 € për kWh kursime vjetore të energjisë. Duke supozuar se komunat kontribuojnë në një të tretën e kostove të investimeve dhe se eficienta e kostos ekuivalente mund të arrihet përmes FKEE ,siç është vlerësuar (kjo do të ishte në përputhje me përvojën rajonale), dhe duke supozuar se kapitalizimi fillestar synohet të disbursohet në periudhë pesë (5) vjeçare, nxjerrë kursime të përlogaritura të energjisë si në Tabelën 10 më poshtë.

Tabela 10. Kursimet vjetore të përlogaritura të energjisë nga FKEE.

Përshkrimi	Vlera
Kontributi në investime nga FKEE në vit	€ 3.5 miliona
Kontributi nga komuna në vit	1.5 € miliona
Eficienca e kostos së supozuar të investimeve	0.44 €/kWh
Kursimet e reja vjetore të energjisë	10.9 GWh/vit
	0.91 ktoe/vit

Burimi: Supozimi nga INDEP.

Më tej, duke supozuar një norme lineare të dorëzimit për periudhën 2021-2030, kjo do të sillte afërsisht 50 ktoe kursime kumulative të energjisë gjatë periudhës.

Për më tepër, sipas studimit të Bankës Botërore⁶⁶ është parashikuar që FKEE të bëjë investime në projekte EE prej rreth 1.0 milion € në Vitet 1 deri në 4, duke u rritur në 1.5 milion € në vit në Vitet 5 dhe 6, 2.0 milion € nga Vitet 7 deri në 10 dhe 2.5 milion € nga Vitet 11 deri në 15. FKEE ka gjasa që të arrijë barazim në aspektin e mbulimit të kostove të tij administrative dhe të përgjithshme nga të ardhurat e tij nga Viti 4 e tutje.

Tabela 11. Përlogaritja e ndikimeve tjera gjatë periudhës 15-vjeçare.

Përshkrimi	Vlera
Investimet kumulative të projektit deri në Vitin 15	27.5€ miliona

⁶³ Po aty, f. 2.

⁶⁴ Raporti i Bankës Botërore (2016), Dokumente të Opsionit për Financimin e Eficiencës së Energjisë në Evropë dhe Azi Qendrore.

⁶⁵ Raporti i Bankës Botërore (2019), Projekti i Eficiencës së Energjisë së Kosovës dhe Energjisë së Rinovueshme, në dispozicion online: <http://documents.worldbank.org/curated/en/607481560546601793/pdf/Disclosable-Version-of-the-ISR-Kosovo-Energy-Efficiency-and-Renewable-Energy-Project-P143055-Sequence-No-10.pdf>

⁶⁶ Banka Botërore (2016), Opsionet për Financimin e Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në Kosovë. Në dispozicion online: <http://documents.worldbank.org/curated/en/607521475846166137/pdf/108848-ESM-P157135-PUBLIC-EE-Options-Paper-Kosovo-ENGLISH.pdf>

Kursimet vjetore të buxhetit të qeverisë deri në vitin 15	4 miliona €
Kursimi i energjisë gjatë gjithë jetës	617 GWh
Reduktimet tërjetësore të GHG	326.850 tonelata të CO ₂ e
Rritja e numrit të vendeve të gjelbërta të punës	<input type="checkbox"/> 500

Burimi: Banka Botërore (2016), Opsionet për Financimin e EE në Ndërtesat Publike në Kosovë.

Sektori i synuar për FKEE në fazën fillestare do të jetë sektori publik, i përqendruar në shkolla, kopshte të fëmijëve, spitale dhe ndërtesa të tjera të komunave. Kjo është në përputhje me drejtimin e politikave të qeverisë në PKVEE e tretë⁶⁷ i cili deklaron implementimin e eficiencës në përdorimin e energjisë në të gjithë sektorët e përdoruesve të energjisë, përkatësisht transportin, industrinë, banesat dhe entitetet komerciale. FKEE gjithashtu do ta vendosë një theks të fortë në angazhimin e sektorit privat, por është shumë herët për të vlerësuar se si kjo do të merr formë. Prandaj, rekomandimi për FKEE është që ta përkrahë sektorin privat sa më shpejt të jetë e mundur, si dhe të kryejë vlerësime të energjisë për t'i identifikuar boshllëqet e masave të EE dhe për të përvetësuar pajisje ose teknologji të reja të EE. Partneriteti i FKEE me Bankën Botërore dhe IFN i ka mundësuar marrësit të përfitojë nga fushat e ndryshme të ekspertizës së këtyre bankave dhe të punojë me ta në mënyrë më të koordinuar nën një kornizë të përbashkët të investimeve. Siç tregohet në studimet e rastit më sipër, partneriteti me IFN i ka mundësuar marrësit të përfitojnë nga aftësitë e ndryshme të këtyre institucioneve, përfshirë aftësinë e tyre për të tërhequr dhe koordinuar financimin në terren, për të dhënë përkrahje më të gjerë të politikave dhe për të dhënë resurse në tregjet dhe teknologjitë në fjalë. Megjithatë shembujt e lartpërmendur nga Fondet e EE japin informata shumë të pasura në lidhje me masat e EE, në veçanti ndikimi i mekanizmave të shëndoshë të shpërndarjes financiare, metodat e tyre të implementimit i marrin parasysh aspektet e tyre kontekstuale (Shih Tabelat 1-6). Me ngritjen e institucionit të ri për eficiencën e energjisë - FKEE, tani shtrohet pyetja a kemi nevojë për Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë? Siç është vërejtur në shumë vite përmes Raportit të Progresit të Kosovës që AKEE ka nevojë për forcim të mëtejshëm, si dhe se Kosova ka shumë agjenci dhe duhet t'i shkurtojë ato. Si rezultat i krijimit të fondit të eficiencës së energjisë, AKEE si agjenci qeveritare është e tepërt dhe mund të bashkohet si departament i ri në Ministri ose të bashkohet me departamentin ekzistues të energjisë (departamenti që para themelimit të Agjencisë ka kryer këto detyra).

7.2 Barrierat e rëndomta

Disa nga pengesat kryesore për funksionimin e FKEE në vitin e parë, si dhe nga përvoja e gjashtë shembujve të fondeve të EE të paraqitura në këtë dokument, gjithashtu sipas një studimi nga Banka Botërore⁶⁸ janë: rikuperimi i kostove operative në vitet e para ishte i vështirë, shfrytëzimi i menaxherit të fondit privat për t'i mbikëqyrur fondet publike mund të mos jetë politikisht i dëshirueshëm, varësia e madhe tek një menaxher i mirë i fondit, bashkëpunimi i dobët në mes të hisedarëve, mekanizmat e nevojshëm për të ndihmuar në sigurimin shlyerjen nga klienti publik, si dhe fondi mund të veprojë në mënyrë monopolistike.

⁶⁷ Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (2017), Plani i tretë Kombëtar i Veprimit për EE (PKVEE) në Kosovë.

⁶⁸ Limaye, D., Singh, J., dhe Hofer, K., (2014), 'Themelimi dhe Operacionalizimi i Fondit Qarkullues të Eficiencës së Energjisë', *Grupi i Bankës Botërore*, f. 3-36

Në rrethanat socio-ekonomike të Kosovës, kjo mund të jetë më pak problem sesa paaftësia për t'i përballuar (më e paaftë sesa e padëshiruar) investimet kapitale. Sidoqoftë, zyrtarët lokalë komunalë, zakonisht nuk i konsiderojnë investimet EE në ndërtesat publike si përparësi të lartë për shkak të mungesës së ekspertizës së brendshme në menaxhimin financiar dhe të projekteve dhe pasigurisë afariste për këto projekte. Konsumatorët kosovarë duhet ta kapërcejnë qëndrimin e tyre relativisht skeptike ndaj efijencës së energjisë dhe të fitojnë më shumë qasje në shërbimet e energjisë.

Një nga kufizimet më të dukshme në Kosovë është se pronarëve të pronave, por edhe familjeve në përgjithësi, u mungojnë të ardhurat e nevojshme për të kryer projekte madhore për modernizimin e ndërtesave ose shtëpive të tyre. Tendenca për mosnënçmim është inerci e sjelljes, apo ngurrim i njerëzve për t'i bërë gjërat ndryshe, për të provuar mënyra të reja ose për të ndërmarrë veprime përballë riskut të perceptuar. Trajtimi i sfidës së ndërtesave të vjetra - përfshirë kufizimin e ndërtesave të trashëgimisë dhe marrjen parasysh të çështjeve të veçanta fizike. Sidoqoftë, sipas draftit të Planit Kombëtar të Ndërtesave Pothuajse Zero-Energjetike (NPZE) nga 1 janari 2021, të gjitha ndërtesat e reja në Kosovë që aplikojnë për leje ndërtimi do duhet të jenë të projektuara sipas NPZE.

Për më tepër, Raporti i Institucioneve Financiare të Efijencës së Energjisë⁶⁹ thekson ndër të tjera problemet e mëposhtme:

- ◊ Mungesa e evidencës për ecurinë e investimeve të EE e vështirëson vlerësimin e përfitimeve dhe të riskut financiar.
- ◊ Mungesa e procedurave dhe standardeve të dakorduara zakonisht për nënshkrimin e investimeve të EE i rrit kostot e transaksionit.

Tabela 12. Si FKKE mund t'i adresojë pengesat kyçe për investimet në efijencën e energjisë.

Barriera ndaj investimeve në EE	Si FKKE mund ta adresojë barrierën?
Përfituesve të mundshëm u mungon dija dhe informacioni për përfitimet e projektit	Të ndërtohet kërkesa për investime të EE përmes shtrirjes dhe marketingut; të demonstron qëndrueshmëria e tyre tregtare; të ofrohen shërbime 'me çelësa në dorë' për ta bërë më të lehtë identifikimin, financimin dhe implementimin e masave të efijencës së energjisë.
Kostot e larta të zhvillimit të projektit dhe transaksionit për shkak të madhësive të vogla të projekteve	Të lidhen projektet e ngjashme; të standardizohen marrëveshjet dhe procedurat.
Tarifat e ulëta të energjisë	Të jepen kushte më të gjata financimi që mundësojnë shlyerjen e kostove të investimeve plotësisht nga kursimet e kostove të energjisë.
Bankat tregtare ngarkojnë norma të larta interesi; entet publike nuk mund të marrin hua	Të lidhen instrumentet pa borxh me njësitë publike (p.sh. MShE, kontrata qiraje, kontrata të performancës së energjisë); Të jepen norma më të ulëta interesi sesa bankat tregtare.

⁶⁹ Raporti i Institucioneve Financiare të Efijencës së Energjisë (2015), në dispozicion online: <https://ec.europa.eu/energy/sites/ener/files/documents/Final%20Report%20EEFIG%20v%209.1%2024022015%20clean%20FINAL%20sent.pdf>

Tregu ESCO është i pazhvilluar; Ofruesit e shërbimeve kanë nivele të ulëta të kapacitetit.	Të shfrytëzohen kontrata të thjeshta ESCO për të ndihmuar në ndërtimin e industrisë lokale ESCO. Të jepen AT për siguruesit e shërbimeve për ta forcuar kapacitetin e tyre;
Përfituesit kanë kapacitet të kufizuar për implementim të masave EE	Të jepen shërbime përkrahëse (p.sh. kryerja e kontrolleve të energjisë; zhvillimi i projekteve teknike; prokurimi i pajisjeve; mbikëqyrja e ndërtimit dhe instalimit; kompletimi i M&V; dhe mbajtja e trajnimit, studimi i rasteve dhe dokumentet dhe shabllonet standarde).

Burimi: Elaborim i INDEP dhe i përvetësuar nga Banka Botërore & ESMAP 2018 (Financimi i Eficiencës së Energjisë, Pjesa 1: Fondet Qarkulluese).⁷⁰

Tabela 12 më lart përmbledh se si FKKE mund t'i adresojë pengesat tipike për investimet në EE. Një avantazh kyç i FKKE është se ai mund të ndihmojë në mbledhjen e fondeve nga qeveria e Kosovës dhe institucionet e ndryshme financiare ndërkombëtare dhe donatorët për ta lehtësuar koordinimin. Gjithashtu, stafi i tij është i përhershëm - ndryshe nga personeli tipik i projektit - duke lejuar dhe mundësuar FKKE-në që të rekrutojë kandidatë të shkëlqyeshëm dhe t'i zhvillojë aftësitë e tyre për periudhë afatgjatë.

7.3. Mjetet për të filluar dhe efektet në tregun e EE

Implementimi i programit FKKE gjatë periudhës së ardhshme duhet të bazohet në përvojën dhe ekspertizën nga ekspertët e punësuar dhe përvojën e fituar gjatë vitit të parë.

Iniciativa për mësim nga gjashtë shembuj. Duke qenë se një pjesë e madhe e portofolit të FKKE tani është në fazën fillestare dhe faza e vargut të projekteve është në zhvillim e sipër, mund të merret parasysh vendosja e 'partnerëve mësimor' - brenda shembujve më të mirë nga shtetet tjera. Kjo do të promovonte kuptim më të mirë, aplikim më efektiv dhe mësim efikas të përqendruar në gjurmimin e rolit transformues të FKKE.

Prandaj, mund të nxirren disa përfundime nga analiza e mësipërme e gjashtë shembujve të fondeve EE. Para së gjithash, një mjet esencial është *rritja e transparencës* mbi mekanizmat e financimit për EE. Pastaj, të dilet me një kornizë për matjen, raportimin dhe verifikimin e këtyre rrjedhave. Me tutje, *konsultimi me shumë hisedarë*, brenda qeverisë, aktorëve të sektorit privat dhe shoqërisë civile, do të duhet të jetë një nga tiparet kryesore të qasjes programore të FKKE dhe duhet të ruhet gjatë implementimit të programeve dhe projekteve të fondeve.

Për më tepër, siç kuptohet në gjashtë shembujt e shqyrtuar, është e rëndësishme që FKKE ta jep përkrahjen e Asistencës Teknike për projektet EE. Në rritjen e lehtësisë për AT, FKKE mund ta kryejë ndërtimin e kapaciteteve për OshE-të dhe akterët tjerë të tregut për ta rritur aftësinë e tyre për kryerjen e auditimeve të energjisë; për shqyrtim, dizajnim, vlerësim, financim, implementim dhe matje të investimeve në EE në sektorin publik.

⁷⁰ <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/30388/129733-BRI-PUBLIC-VC-LW88-OKR.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

Një tjetër mjet kyç që FKKEE duhet ta zhvillojë është *Strategjia e marketingut*, plani i investimeve dhe zhvillimi e biznesit të qëndrueshëm për të financuar projekte të EE që nuk shërbehen nga bankat komerciale, duke filluar me sektorët komunal dhe publik.

Siç është vërejtur nga studimet e rastit, mjeti më i shquar është *Marrëveshje MShE*. Kështu, FKKEE do të hyjë në MShE me komunat për të financuar investimet EE të rëna dakord në ndërtesat publike komunale, me MShE jo të klasifikuara si borxh komunal.

Siç ilustron Figura 3, Marrëveshjet e Shërbimit të Energjisë do të jenë instrumenti kryesor i FKKEE për implementimin e investimeve EE në Subjektet Publike në kuadër të komponentit qarkullues. MShE nënshkruhet në mes të FKKEE dhe një entiteti publik që ia mundëson FKKEE-së t'i investojë fondet e tij në një projekt EE dhe t'i rikuperojë investimet nga entiteti publik, bazuar në kursimet e projektuara të kostos së energjisë.




Figura 4. Pagesat sipas Marrëveshjes së Shërbimit të Energjisë (ESMAP, 2014).

Mjetet e MShE mund të jenë shumë të dobishme për komunat me kredi të dobëta dhe mungesë kapaciteti dhe mund ta lehtësojnë tërheqjen e financave private në programet e investimeve EE. Përveç kësaj, FKKEE do ta sigurojë një paketë të shërbimit të plotë, përfshirë dhënie të financimit, auditimin e energjisë, dizajnin teknik, prokurimin dhe mbikëqyrjen e kontraktuesve, masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale, matjen dhe raportimin e kursimit të energjisë. Nga ana e saj, komuna shlyen kostot e zhvillimit të projektit dhe investimit nga kursimet e energjisë (deri në 15 vjet). Një mjet tjetër nga studimet e rasteve sugjeron që FKKEE duhet të mendojë për *lidhjen në pako të disa* projekteve së bashku për një çmim më të mirë dhe për ta ulur koston e transaksionit, si dhe nevojitet monitorimi dhe kontrolli i rreptë i implementimit të projektit në mënyrë që të shmangen abuzimet e mundshme në terren. Një mësim i nxjerrë nga praktikatat e mira të fondeve të sipërpërmendura është informimi i qytetarëve dhe angazhimi i hisedarëve është thelbësor që fondi EE të përparojë. *Fushata e vetëdijësimit dhe marketingut* është hapi i parë i njohjes së përdoruesve të mundshëm dhe i hisedarëve për

mundësitë që u ofrohen atyre. Sipas përvojës Kroate, lidhja e aktiviteteve të forta promovuese me procedurat e thjeshta të aplikimit dhe përkrahja e vazhdueshme e ofruar për zhvilluesit e projekteve provuan të jenë rruga përpara. Kështu, procedura e aplikimit luan gjithashtu rol të rëndësishëm dhe rekomandohet të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur. Kroacia me vetëm 30 ditë të procedurës së aplikimit⁷¹ është e para që e ka adoptuar këtë zgjidhje.

Në vitin 2007 dhe 2008 Banka Botërore⁷² e ka lavdëruar Fondin Bullgar të Eficiencës së Energjisë si një “operacion shumë të kënaqshëm (ose praktika më e mirë), dizajni dhe implementimi i së cilit duhet të shpërndalet në nivel ndërkombëtar”. Kështu, procesi i aplikimit financiar për fondin bullgar EE⁷³ është shembull i mirë dhe përbëhet nga tetë hapa siç tregohet në tabelën më poshtë.

Tabela 13. Procesi i Aplikimit për Financim EE dhe Cikli i Projektit.

Hap i nr.	Veprimi	Kryhet nga
1	Identifikimi i projektit: d.m.th. dorëzimi i rezultateve të kontrollit të detajuar të energjisë ose i propozimit për implementimin e një sërë masash për kursimin e energjisë	Zhvilluesi i projektit
2	Shqyrtimi fillestar i projektit	Fondi EE
3	Kompletimi i Propozimit Fillestar të Projektit (PFP)	Zhvilluesi i projektit
4	Dorëzimi i PFP dhe i dokumenteve shoqëruese pranë FKEE	Zhvilluesi i projektit
5	Asistenca në dizajnimin e projektit dhe kompletimin e dokumenteve përkatëse	Fondi EE
6	Vlerësimi i projektit dhe i aftësisë kreditore	Fondi EE
7	Vendimi formal për miratimin për financim	
8	Përgatitja dhe nënshkrimi i kontratës për financimin dhe disbursimin e fondeve	Fondi EE dhe zhvilluesi i Projektit

Një tjetër mjet jashtëzakonisht i rëndësishëm në epokën e digjitalizimit është nevoja për të dhënë informata online me qasje miqësore për përdoruesit, ku përdoruesit fundor mund t'i gjejnë informatat e nevojshme në lidhje me nevojat e tyre.

Siç u përmend nga studimet e rastit *vetëdijësimi i përdoruesve të fundit*, FKEE duhet të mendojë për dhënie të informatave për projektet e EE gjatë gjithë vitit përmes qasjes interaktive online, ku përdoruesit fundor mund ta gjejnë informatën e duhur në lidhje me nevojat dhe preferencat e tyre. Rrjeti i këshillave të energjisë, këshillat në terren, kalkulatorët e kursimit të energjisë janë disa nga mjetet që mund të implementohen për të rritur vetëdijen.

Gjetjet e shembullit moldav do të ishin me rëndësi të menjëhershme për FKEE në atë që lidhet me *vizitën për implementimin e projektit* dhe t'i kontrollohen punimet e vazhdueshme duke konfirmuar se materialet janë me cilësinë më të mirë për të siguruar kursimet EE. Kështu, rastet studimore tregojnë se *monitorimi dhe vlerësimi i qëndrueshëm* janë të nevojshme për të arritur rezultate.

Nëpër shembujt e shqyrtuar të fondeve të EE, praktikat e menaxhimit ndryshojnë shumë, por një mësim nga të gjithë është rëndësia e *Menaxherit të fondit* që rezulton në suksesin e përgjithshëm të

⁷¹ <https://balkangreenenergynews.com/supporting-energy-efficiency-and-renewables-in-croatia-the-role-of-environmental-protection-and-energy-efficiency-fund/>

⁷² <http://econoler.com/wp-content/uploads/2017/10/EconolerBulgarie2017FINALentier.pdf>

⁷³ <http://econoler.com/wp-content/uploads/2017/10/EconolerBulgarie2017FINALentier.pdf>

fondit. Prandaj, struktura e duhur menaxhuese e Fondit duhet të jetë çështje esenciale për funksionimin e mirë të FKEE. Për më tepër, një qasje e re për shembullin kroat dhe rumun është përdorimi i 'ofrujes i të gjitha shërbimeve'.

Për t'i kuptuar më mirë risqet dhe përfitimet për financuesit dhe investitorët në sektorin EE, rekomandohet shumë që FKEE t'i përdorë platformat e mëposhtme EE online nga praktikat më të mira Evropiane për parashikimin e kursimeve të energjisë, optimizimin e performancës, etj.

Së bashku me Grupin e Institucioneve Financiare të EE⁷⁴, KE ka lansuar në 2016 *Platformën e de-rrezikimit të Eficiencës së Energjisë*⁷⁵ e cila është databaza më e madhe pan-evropiane me burim të hapur e projekteve EE. Platforma ndërton evidenca të performancës dhe ndihmon zhvilluesit e projekteve, financuesit dhe investitorët të vlerësojnë më mirë risqet dhe përfitimet e investimeve të eficiencës së energjisë në tërë Evropën.

Po aq e rëndësishme për FKEE është mjeti *Paketa e marrjes së riskut tek huatë*,⁷⁶ i cili është udhëzues për vlerësimin e vlerës dhe riskut për financimin e eficiencës së energjisë, i lansuar në qershor 2017. Ai synon t'i ndihmojë institucionet financiare ta përshkallëzojnë zbarkimin e kapitalit në eficiencën e energjisë. Për rol më transformues, FKEE duhet t'i *targetojë tregjet e ardhshme* (sektori privat, transporti dhe industria) dhe sistemet tjera me ndikime të qëndrueshme në shkallë të gjerë që përshpejtojnë ose zhvendosin trajektoren drejt karbonit të ulët. Si për shembull, të fondit kroat, sektori i transportit po subvencionohet për blerjen e veturave elektrike. Shembulli bullgar i garancisë kreditore për amvisëritë është një mjet i dobishëm që mund të përdoret në të ardhmen e afërt për sektorin rezidencial. Në lidhje me burimet e financimit, shembulli i fondit të Tajlandës përfshin taksën për përdorimin e benzines së veturave. Duke përdorur shembullin kroat, FKEE mund ta fusë në përdorim tarifën e taksës mjedisore.

Në lidhje me *efektet në tregun e eficiencës së energjisë*, pasi që sektori EE është treg relativisht i ri në Kosovë, komuniteti financiar është ende i panjohur me risqet e përfshira në projektet e rinovimit. Tregu është ende në zhvillim, ai ka përvojë dhe aftësi të kufizuara teknike, të zhvillimit të biznesit dhe administrimit të riskut në sektorin e EE, duke i shtuar risqet e perceptuara nga investitorët.

Është e qartë se institucionet financiare me prani në të dyja anët e furnizimit dhe kërkesës, përfaqësojnë një nga kontribuesit më esencial për zhvillimin e tregut të EE. Gjithashtu, arsyeja pse EE ende nuk është në listën prioritare për konsumatorët qëndron në faktin se kthimet e ngadalta në investimet EE ende perceptohen si të padobishme në krahasim me koston e faktorëve të tjerë dhe faktin që çmimet e energjisë janë ende relativisht të ulëta. Kështu, duke e prezantuar një fond të themeluar rishtazi për EE, një mekanizëm të qëndrueshëm të shpërndarjes financiare për projektin EE duhet të vendoset në organin ndihmës për të dhënë hua me norma preferenciale, së pari për sektorin publik – komunat, e më pas për amvisëritë rezidenciale.

Programet dhe aktivitetet qeveritare janë të tepërta ose joefikase nëse më shumë se një institucion përfshihet në të njëjtën fushë të gjerë të nevojës kombëtare, e cila mund të rezultojë në joefikasitet në mënyrën e dhënies së shërbimeve. Kështu, duhet marrë parasysh institucionin e sapoformuar FKEE (një pjesë e detyrave mbivendosen me AKEE) dhe konsideruar shumë vërejtjeve që vijnë nga

⁷⁴ Grupi i Institucioneve Financiare të Eficiencës së Energjisë, në dispozicion online: <http://cefig.eu>

⁷⁵ Platforma e de-rrezikimit të Eficiencës së Energjisë, në dispozicion online: <https://deep.cefig.eu/>

⁷⁶ Paketa e marrjes së riskut tek huatë, në dispozicion online: <https://valueandrisk.cefig.eu>

Raportet e Progresit të KE për Kosovën (nga 2015⁷⁷ deri në 2019⁷⁸) mbi kapacitetet e gjithëmbarshme të kufizuara të AKEE dhe duke qenë me staf të mangët, përfshirë vërejtjet e fundit nga Komisioni Evropian për numrin e madh të agjencive në Kosovë dhe nevojën për zvogëlimin e numrit të tyre, në përpjekjet për t'i zvogëluar shpenzimet e panevojshme. Gjithashtu, duhet duke marrë parasysh që para themelimit të AKEE, shumica e punës për eficiencën e energjisë ishte kryer nga departamenti i energjisë në Ministri.

Pas gjithë kësaj, INDEP konsideron që pas tetë viteve të punës (themeluar në 2012), AKEE është e tepërt si agjenci. Prandaj sugjerohet që AKEE të bashkohet me Departamentin e Energjisë ose si një Departament i ri për Eficiencën e Energjisë në Ministri.

FKEE duhet të jep më shumë financa koncesionare multilaterale për EE më shpejt se çdo investim tjetër dhe luan rol të rëndësishëm në adresimin e pengesave për investime. Është e përshtatshme edhe të përkrahen disa nga nevojat më urgjente për investime në EE dhe për t'u përkrahur tregu i përgjithshëm i EE në Kosovë që po shkon përpara. FKEE e qëndrueshme do të mund ta sigurojë shkallën dhe tipin e përkrahjes për marrësin për të nxitur tregun e EE në Kosovë.

Përmes FKEE, Kosova siguron stimuj për vullnetin e drejtuar dhe të organizuar për të bërë përparim në fushën e EE por gjithashtu edhe një forum fleksibil dhe krijues për lëvizjen e projekteve individuale në komunitete të ndryshme, me burime, orare, individë dhe kompani të ndryshme. Kështu me funksionimin e tij, FKEE e promovon zhvillimin e një tregu funksional EE në Kosovë. Rezultat duhet të jetë një FKEE e qëndrueshme që do ta përkrahë një treg më të fortë të EE dhe forcon ofruesit e shërbimeve të energjisë përmes mekanizmave të tij të shpërndarjes financiare.

Figura 4 më poshtë tregon faktorin ndikues në tregun e EE.




Figura 5. Tregu i EE në Kosovë dhe faktorët ndikues (Burimi: Analiza nga INDEP).

Për më tepër, përfitim është inkurajimi i shfrytëzimit të teknologjive të reja EE, për ta stimuluar përfshirjen e sektorit financiar (institucionet bankare) në mënyrë që t'i përkrahin programet kombëtare të qeverisë për EE, për t'i rritur kursimet e mundshme të energjisë, d.m.th. zvogëlimin e konsumit të energjisë elektrike, uljen e emetimet e gazeve serrë (GHG).

⁷⁷ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

⁷⁸ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

Tregu i eficiencës së energjisë është relativisht i ri për Kosovën, kështu që edhe aktorët kryesorë të saj nuk kanë njohuri të mjaftueshme të mjeteve dhe mekanizmave në dispozicion për implementimin e projekteve. Duke ditur se çmimet e energjisë janë një nga faktorët kryesorë që nxisin zgjerimin e tregjeve me eficiencë të energjisë.⁷⁹ Investimet e ardhshme në sektorin privat janë propozuar të jenë direkte por edhe indirekte, duke stimuluar sektorin privat në implementimin e investimeve për EE. Faktori kufizues për FKKE për t'i përkrahur investimet eventuale në sektorin privat është madhësia e vlerës së investimeve të kërkuara.

Sidoqoftë, sipas dokumenteve të shqyrtuara, ka disa kufizime për një fond qarkullues që mund të çojë në shtrembërim të tregut financiar dhe në të vërtetë ta pengojë zhvillimin komercial dhe të qëndrueshëm⁸⁰ pasi që fondet qarkulluese kanë kufij në mobilizim të financave private dhe qarkullojnë mjaft ngadalë.⁸¹

Prandaj, për përmirësimin e tregut të EE, FKKE do të duhet ta krijojë një platformë bashkëpunuese në mes të ESCO si në menaxhimin e programit ashtu edhe në nivelin operacional, duke rezultuar në investime të zgjeruara në masat e EE. Në përmirësimin e tregut të saj të EE, Kosova mund të mësojë nga Fondi Hungarez i Garantimit të Eficiencës së Energjisë (1997–2005)⁸² i cili hapi terren duke qenë fondi i parë i tillë që i përdorë garancitë për ta lehtësuar huadhënien komerciale për eficiencë të energjisë. Fondi u shkri me Programin rajonal të Komercializimit të Financave të EE në 2005.

Rasti i Hungarisë demonstroi se ristrukturimi i hershëm i sektorit të energjisë, reformat e mira institucionale, sektori bankar dhe programet e strukturuara të ndihmës mund të çojnë në rezultate të rëndësishme pozitive në shtetet në tranzicion në biznesin kontraktues të performancës së energjisë⁸³. Kjo gjithashtu na lejon të konkludojmë se ESCO-të dhe financimi i palëve të treta mund të luajë rol të rëndësishëm në arritjen e pikësnyimeve të EE nëse sigurohet një mjedis i mirë për biznes. Rasti më i suksesshëm për biznesin ESCO në Evropë është rasti i Hungarisë. Për shembull, IEA⁸⁴ e konsideron Hungarinë si “një nga shtetet udhëheqëse në zhvillimin e fushës së ESCO-ve në vitet ‘90”. Sipas autorit Vine, përllogaritet se 80% e veprimtarisë ESCO në Hungari synon sektorin komunal; 20% e mbetur ndahet në mes të sektorëve të industrisë dhe rezidencial⁸⁵. Projektet tipike ESCO përfshinin ndriçimin publik, ngrohjen qendrore dhe investimet e kombinuara të nxehtësisë dhe energjisë. Shembulli hungarez ESCO ofron një model që mund të kopjohet lehtësisht në Kosovë.

⁷⁹ Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (2013), Raporti i Tregut të Eficiencës së Energjisë 2016. Paris: IEA.

⁸⁰ Taylor RP, Govindarajulu C, Levin J, Meyer AS, Ward WA, (2008), Financimi i eficiencës së energjisë: *Mësimet nga Brazili, Kina, India dhe përtej*. Uashington, DC, SHBA: Banka Botërore.

⁸¹ Kats BG, Author P, Menkin A, Dommu J, Debold M, (2012), Financimi i eficiencës së energjisë.

⁸² Banka Botërore & ESMAP (2018), Financimi i Eficiencës së Energjisë, Pjesa 1: Fondet qarkulluese, në dispozicion online: <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/30388/129733-BRI-PUBLIC-VC-LW88-OKR.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

⁸³ Üрге-Vorsatz dhe të tjerët. (2004), Pse Hungaria? Mësimet e nxjerra nga suksesi i industrisë hungareze ESCO.

⁸⁴ Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë-IEA, (2003b), Teknologjitë për Reduktimet e ndjeshme të Gazit Serë nga Energjia, OECD/IEA, Paris, në ardhje.

⁸⁵ Vine, E. (2003), “Një anketë Ndërkombëtare e Kompanive të Shërbimit të Energjisë”, Lawrence Berkeley National Laboratory, Berkeley, CA. Në dispozicion online: <http://econolinerint.com/English/articles%20and%20lectures/Final%20intESCOpaper%206%2023%2003.pdf>

Përfundim

Ndryshimi është i pashmangshëm dhe është e qartë se Kosova ka nevojë për ndryshim në sektorin e eficiencës së energjisë. Fondet Kombëtare të Eficiencës së Energjisë po del të jetë mjeti kyç për të ndihmuar në menaxhimin e sektorit të përgjithshëm të eficiencës së energjisë dhe transformimin në karbon të ulët, si dhe për të ndihmuar qeverive në arritjen e objektivave të saj të eficiencës së energjisë. Prandaj, Kosova e themeloi një institucion të ri të financimit të EE në vend, FKKE, në vitin 2019. FKKE është akoma në fazë fillestare dhe do të nevojitet kohë shtesë për ta zhvilluar një prani të fortë në tregun e EE dhe për ta bërë fondin sa më efektiv në zgjerimin e sektorit të synuar. Dëshmitë empirike sugjerojnë se nuk ekziston një gjë e tillë si një fond plotësisht eficient, mbetet vetëm një ide drejt së cilës shumica e shteteve bëjnë përpjekje të shkojnë.

Për më tepër, mekanizmat e ri institucional nuk mund të pritet të zhvillohen dhe të rriten brenda ditës dhe për këtë arsye kërkohen përpjekje të qëndrueshme. Sukseset e arritura në zhvillimin e skemave të huasë për eficiencë të energjisë në gjashtë praktikatat më të mira të përmendura më lart, si shembull, kanë qenë rezultat i disa viteve me përpjekje të vazhdueshme. Në shumicën e rasteve, përkrahja e qëndrueshme dhe strategjike e qeverisë dhe donatorëve ndërkombëtarë është faktor shumë i rëndësishëm mundësues për llojin e kërkuar të zhvillimit institucional për ta përmirësuar vërtet ofrimin e financimit për eficiencë të energjisë.

Në mënyrë që t'i sigurohen mjetet më të mira për një FKKE të qëndrueshme, janë analizuar në thellësi përvoja e çmueshme dhe mësimet e nxjerra nga funksionimi i gjashtë fondeve të EE. Është synuar të ishim praktik dhe t'i prezantojmë disa nga qasjet më të suksesshme që mund t'i formojnë themelet e funksionimit të qëndrueshëm të FKKE. Më tej, i diskutuam mjetet për një FKKE transformuese dhe rolin e tij në tregun e EE dhe disa nga përfitimet që Fondi mund t'i sjellë të cilat mund t'i sjellin hisedarët së bashku. Nga gjashtë studimet e rastit, koncepti, qasja për shfrytëzim të fondeve qarkulluese u dëshmua e suksesshme, gjë që mund të jetë në dobi të FKKE në përdorimin e mekanizmit të tij qarkullues për t'u bërë plotësisht i vetë-qëndrueshëm.

Por sfidat e vërteta për përshpejtimin e eficiencës së energjisë qëndrojnë në themelet e saj të politikave: kornizat e qeverisjes së politikave, mundësia për përfitime që mundësohet nga politikat e shëndosha financiare dhe shërbimet që mundësojnë eficiencën e energjisë me çmime që pasqyrojnë kostot dhe masat përkrahëse. Si rrjedhojë, Qeveria duhet ta çmojë më shumë nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj eficiencës së energjisë në lidhje me energjinë dhe ndryshimin e klimës, duke rezultuar në zgjerimin e ardhshëm të fushës së fondit në mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave. Përmes FKKE, Kosova siguron stimuj për vullnetin e drejtuar dhe të organizuar për të bërë përparim në fushën e EE por gjithashtu edhe një forum fleksibil dhe krijues për lëvizjen e projekteve individuale në komunitete të ndryshme, me burime, orare, individë dhe kompani të ndryshme.

Gjetjet tona sigurojnë njohuri nga një numër i mësimëve (përdorimi i asistencës teknike, ngritja e vetëdijes, krijimi i vargut dhe de-rrezikimi etj.) nga gjashtë shembujt e paraqitur më lart (Tabelat 3-8) për ata që e konsiderojnë ofrimin e financave EE në sektorin publik dhe atë privat si në periudhën afatshkurtër ashtu edhe në atë afatmesme dhe afatgjatë. Bazuar në gjashtë studimet e rastit dhe me përkrahjen e qeverisë, IFN-ve dhe hisedarëve të tjerë, FKKE i qëndrueshëm mundet ta rritë nivelin e punësimit me “vende pune të gjelbra”, ta përmirësojë tregun e eficiencës së energjisë dhe t'i zbutë ndryshimet klimatike. Me përdorimin e mjeteve të mësipërme, FKKE duhet të jetë në gjendje ta përkrahë masën EE nga PKVEE i 4-të i ardhshëm, projektet dhe qasjet për transformimin e papenguar të tregut të eficiencës së energjisë.

FKEE si një institucion i ri i financimit të EE në vend dhe partneri kryesor zbatues për PKEE, qëllimi i të cilit është zbatimi i nënprojekteve të kursimit të energjisë në objektet komunale. Prandaj ai i merr përgjegjësinë e agjencisë zbatuese për projektet e EE nga ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, më vonë MEPTINIS e tani Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit (MEM). Me krijimin e institucionit të ri në sektorin e eficiencës së energjisë, puna e AKEE është e tepërt. Kështu, ne rekomandojmë që AKEE të bashkohet me departamentin e energjisë në Ministri ose si departament i ri për Eficiencë të Energjisë brenda MEM.

Në përfundim, FKKEE e qëndrueshme mund ta ndihmojë Qeverinë e Kosovës në arritjen e caqeve kombëtare në EE për vitin 2020 e tutje. FKKEE do të ndihmojë në reduktimin e importeve të energjisë dhe të kostos publike për energji, në përmirësimin e niveleve të komoditetit, në meremetimin e stokut të ndërtesave publike, krijimin e një industrie ESCO dhe të vendeve të reja të punës dhe në uljen e emetimit të gazeve serë (GHG).

8. Rekomandimet

Gjetjet e mësipërme identifikuan 14 rekomandime që FKEE dhe Qeveria duhet t'i përvetësojnë për ta forcuar rolin transformues. Prandaj, INDEP rekomandon të mëposhtmet ose kombinimet e tyre:

- I. ***Qeveria duhet ta përcaktojë eficiencën e energjisë si një prioritet kombëtar të infrastrukturës dhe ta përgatisë një varg të projekteve të forta EE në infrastrukturën publike.***

Gjatë rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë, qeveria duhet ta vendosë eficiencën e energjisë si një prioritet për infrastrukturën kombëtare me fokus në teknologjitë kyçe të eficiencës së energjisë që do ta sigurojë potencialin më të lartë për përmirësimin e eficiencës së energjisë.

Lidhur me vargun e projekteve të EE, është e rëndësishme të hartohet në bashkëpunim i fortë me hisedarët përkatës.

- II. ***Me krijimin e institucionit të ri (FKEE), AKEE bëhet e tepërt.***

Në mënyrë që të arrihet qëllimi më i gjerë i përmirësimit të eficiencës së energjisë, mbivendosjet mund të rezultojnë në përpjekje të tepërta dhe burimet e alokuara shkojnë dëm. Zonat gri të krijuara nga mbivendosjet duhet të qartësohen nga qeveria dhe funksionet e tyre duhet të përparojnë së bashku. Prandaj, marrë parasysh institucionin e sapoformuar FKEE (ku një pjesë e detyrave mbivendoset me FKEE), dhe pasi që Agjencia ka punuar me një numër të kufizuar të zyrtarëve (3-5), rekomandohet që të sistemohen brenda departamentit të energjisë të MEM. Një opsion tjetër është krijimi i një departamenti të ri të eficiencës së energjisë brenda MEM, por kjo do ta kushtëzojë hartimin dhe miratimin e rregullores së re të brendshme të Ministrisë.

- III. ***Qeveria dhe FKEE duhet të fillojnë implementimin e kontratave të performancës për kursimet e energjisë.***

Së pari Qeveria duhet ta miratojë rregulloren ESCO dhe pastaj me implementimin e projekteve të ardhshme të EE, FKEE do t'i nënshtrohet një kontrate të performancës për kursimin e energjisë, e cila do të rezultojë në zhvillimin e tregut ESCO (kompanitë e shërbimit të energjisë) në Kosovë.

- IV. ***FKEE duhet ta krijojë Lehtësinë e Asistencës Teknike si mjeti më i mirë sipas shumicës së shembujve të fondeve EE.***

Me këtë Lehtësi, FKEE do t'i ndërtojë kapacitetet (OShE) dhe aktorët tjerë të tregut për ta rritur aftësinë e tyre për kryerjen e auditimeve të energjisë; për shqyrtim, dizajnim, vlerësim, financim, implementim dhe matje të investimeve në EE në sektorin publik. Kjo lehtësi mund të bëhet si qendër e ekspertizës EE dhe të përfshihet si pjesë e një AT në mënyrë që të mbajë trajnime periodike për të ndarë mësim nga projektet e mëparshme,

gabimet e zakonshme dhe trajnime në përdorimin e duhur të pajisjeve dhe teknologjive të reja si dhe aplikimin e sistemeve të kontrollit të menaxhimit të energjisë.

FKEE duhet t'i shfrytëzojë platformat evropiane të EE të tilla si *Platforma e de-rrezikimit të Efiçiensës së Energjisë dhe paketën e marrjes së riskut tek buatë*.

- V. ***FKEE duhet të punësojë specialistë ndërkombëtarë afatshkurtër me njohuritë në menaxhimin e projekteve EE, vlerësimin e riskut kreditor, dhe disbursimin dhe shlyerjen e kredive.***

Për ta siguruar implementimin e lehtë të projektit dhe ndërtimin e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve të Energjisë, FKEE duhet t'i përgatisë Termat e Referimit (TeR) dhe ta punësojë një specialist afatshkurtër ndërkombëtar për EE.

- VI. ***Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit së bashku me Komunat duhet t'i shqyrtojnë dhe t'i miratojnë të gjitha 38 Planet Komunale për Efiçiençë të Energjisë (PKEE) si dhe t'i përpilojnë listat e ndërtesave me performancën më të dobët në komunat e Kosovës.***

Me miratimin e PKEE, komunat do të mund të aplikojnë për fonde nga FKEE dhe të dinë saktësisht se në cilat ndërtesa komunale kanë më shumë nevojë për implementimin e masave EE.

- VII. ***FKEE përmes një pilot-projekti duhet të jetë “shembull” në krijimin e një ose dy ndërtesave ekzistuese “NZEB” në Kosovë.***

Për ta dhënë një shembull të mirë dhe për ta rritur vetëdijen për përfitimet shoqërore, ekonomike dhe mjedisore të realizimit të masave të efiçiensës së energjisë në ndërtesa, FKEE duhet ta ketë mundësinë që t'i demonstrojë ndërtesat me “Energji Neto-Zero” në rajonet kryesore të Kosovës si sfidë ndaj agjencive tjera qeveritare kombëtare, rajonale dhe lokale që të përputhen ose t'i tejkalojnë ndërtesat më të mira me efiçiençë energjetike të cilat i ka zhvilluar vet, dhe tu jep shpërblime atyre njësive të qeverisë që e bëjnë këtë. FKEE rekomandohet të fillojë pilot projektin brenda ambienteve të zyrës së tij si NPZE e parë në Kosovë. Për më tepër, të punohet në bashkëpunim të ngushtë me Parkun e porsakrijuar të Trajnimit për Inovacion në Prizren për ta bërë një nga ndërtesat brenda parkut (NPZE).

- VIII. ***Për burime të qëndrueshme financimi, FKEE duhet ta prezantojë përdorimin e politikave fiskale (taksat dhe tarifave të përdoruesve) për transport dhe mjedis.***

Përveç financimit nga aktorët ndërkombëtarë dhe rajonalë, duhet doemos të zhvillohet një burim i besueshëm i financimit. Kështu, sipas shembullit të fondit EE të Tailandës, ndryshimi i politikave fiskale do të duhet të përgatitet dhe implementohet në vitet e ardhshme për ta siguruar qëndrueshmërinë e FKEE. Përveç kësaj, sipas shembullit kroat, opsioni i financimit mund ta përfshijë vendosjen e tarifave për ndotësit e mjedisit dhe tarifa të veçanta mjedisore për automjetet motorike.

- IX. ***FKEE në vitet e mëvonshme të funksionimit duhet ta zgjerojë fushën e tij për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave si dhe ta ndryshojë emrin në “Fondi Eko dhe për Eficiencë të Energjisë i Kosovës”.***

Siç tregohet në shembujt kroatë dhe tajlandezë, rekomandohet që në vitet e ardhshme dhe si nevojë për burime të tjera të financimit, FKEE duhet ta hartojë një rregullore të re dhe ta zgjerojë cakun e saj për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave, si dhe ta futë në përdorim taksën mjedisore si një burim i ri i financimit. Në lidhje me zgjerimin e objektivave në sektorin e mjedisit dhe me shkrijen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Mjedisit, do të jetë më e lehtë të arrihen objektivat e reja mjedisore dhe të emërohet fondi si **“Fondi Eko dhe për Eficiencë të Energjisë i Kosovës”**.

- X. ***FKEE duhet t’i lidhë së bashku disa projekte të vogla dhe ta shkurtojë procedurën e aplikimit.***

Lidhja e disa projekteve të ngjashme është i nevojshëm për ta formuar një qasje të qëndrueshme ndaj projekteve EE, veçanërisht pasi që ato kanë kosto të lartë të projektit dhe transaksionit.

Një mjet i rëndësishëm i rekomanduar për KEEF FKEE që buron nga studimet e rastit është që të sigurohet procesi i lehtë dhe sa më i shkurtër i aplikimit, sikur te shembulli kroat (30 ditë). Për më tepër, anëtarët e bordit të FKEE dhe ekipi menaxhues duhet të promovojnë lidhjen e projekteve të vogla të ngjashme së bashku për ta fituar një çmim më të mirë dhe për t’i ulur kostot e transaksionit, si dhe për monitorim dhe vlerësim më të mirë dhe efikas të projektit.

- XI. ***FKEE duhet ta zgjerojë fushën e synuar në sektorin privat (amvisëritë).***

Me shfrytëzimin e nivelit më të lartë të energjisë elektrike dhe të një pjese të konsiderueshme të energjisë për ngrohje dhe ftohje nga familjet, potenciali më i madh i eficiencës së energjisë është në nivelin e pronarit të shtëpisë dhe të pronarit të ndërtesës. Siç tregohet nga shembujt e lartpërmendur të fondit EE, pjesa kryesore e aplikimit të projekteve EE erdhi nga retrofiti EE i amvisërive. Prandaj, rekomandohet që të zgjerohen shumë nga programet ekzistuese të eficiencës së energjisë për sektorin rezidencial për të arritur kursime më të larta të energjisë në mënyrë që të shtohen njohuritë dhe të përmirësohen zgjedhjet e njerëzve. Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit dhe FKEE duhet ta përgatisin një studim mbi stimujt EE për sektorin privat dhe amvisëritë me përfshirjen e qasjes në masat EE për konsumatorët e prekur nga varfëria energjetike.

- XII. ***Siç u tregua në gjashtë shembuj e fondeve EE, një FKEE i qëndrueshëm ka nevojë për një menaxher ose ekip menaxhues të fortë dhe të aftë në monitorimin e projekteve EE.***

Në mënyrë që ta sigurojë qëndrueshmërinë e vet përgjatë viteve, FKEE duhet ta bëjë çdo përpjekje për ta krijuar një aftësi ose kornizë të qëndrueshme të përcjelljes dhe vlerësimit

që do të futet në databazë me të gjitha shifrat përkatëse. Menaxheri i fondit duhet ta monitorojë tërë ciklin e projekteve EE për të siguruar implementimin e tyre të plotë.


XIII. *FKEE duhet të zhvillojë strategjinë e tregut dhe të realizojë fushata të vetëdijesimit.*

Siç u tregua në gjashtë studimet e rasteve, boshllëqet e njohurive dhe faktorët e vetëdijesimit dëshmojnë se janë pengesë e vazhdueshme dhe e spikatur ndaj investimeve në efikasitet të energjisë. Prandaj, për zhvillimin e strategjisë së marketingut dhe realizimin e fushatës vetëdijese, FKEE duhet të shpallë thirrjen publike për angazhimin e një kompanie për shërbime të komunikimit. Duhet të zhvillohet një strategji e marketingut për secilin treg të synuar me mjete divergjente për arritjen e objektivit të synuar. Prandaj, së bashku me agjencitë ndërkombëtare për zhvillim, të realizohet një fushatë marketingu dhe të organizohen konferenca vjetore të Javës EE, të promovohet dhe të kultivohet një marrëdhënie më e mirë në mes të të gjithë aktorëve institucionalë, investitorëve dhe konsumatorëve në lidhje me efikasitetin e energjisë dhe të gjitha përfitimet nga ajo.

XIV. *FKEE duhet të realizojë rishikime financiare (p.sh., buxhetim, prokurim, financa komunale).*

Për ta siguruar qëndrueshmërinë e tij, për ta forcuar punën, për ta zhvilluar biznesin e ardhshëm dhe planet e rikapitalizimit, FKEE duhet ta përgatitë planin pesë-vjeçar të investimeve dhe planin e ri-kapitalizimit financiar.

Aneksi I. Skema e organizimit të brendshëm të personelit të FKEE



Burimi: Rregullorja e brendshme e FKEE⁸⁶

⁸⁶ http://fkee-rks.net/file/repository/2_IR_int_org_employment_and_remuneration_of_KEEF_ENG_19_2_2019.pdf

Publikim i *Institutit për politikat zhvillimore* (INDEP) Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme automatike, apo të transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti pa pëlqimin paraprak nga botuesi. Publikimi mund të shpërndalet në formë elektronike, vetëm në tërësinë e tij dhe për qëllime jotregtare.

